



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 28.05.2020)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.90, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 16:55.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Ilir Toska | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 9. Erjon Muharremaj | (anëtar) |

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 28.05.2020 (Pika 1)***

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, *zoti Dritan Hallunaj.*

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtoresh pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.90, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Këshilli i Lartë Gjyqësor u mbledh sot më datë 28.05.2020, me të pranishëm 10 anëtarë (nuk mori pjesë në mbledhje zoti Dritan Hallunaj), për të shqyrtuar një rend dite me 10 pika. Me kërkesë të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, kryetarit të Komisionit, dhe pas votimit nga anëtarët, u miratua për t’u shtuar edhe një pikë e 11-të “Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Merr fjalën zoti Toska i cili lexon relacionin shpjegues mbi projektvendimin “Për

fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.90, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”

Ndër të tjera, në relacion parashtrohet se pas përfundimit të afatit për kandidimin në pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.90, datë 26.02.2020 më datë 13.05.2020, rezulton se kanë kandiduar 3 kandidatë (znj. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}) të cilat janë në proces e sipër të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për procedurën e ngritjes në detyrë të hapur me Vendimin nr. 88, datë 26.02.2020 si dhe ndërkohë 2 prej tyre (znj. {...} dhe znj. {...}) janë në proces verifikimi të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit edhe në procedurën e ngritjes në detyrë të hapur me Vendimin nr. 89, datë 26.02.2020.

Rezulton se kandidatet znj. {...} dhe znj. {...}, kanë aplikuar në të pesë pozicionet e lira në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të hapura me Vendimet nr. 88, nr. 89, nr. 90, nr. 91 dhe nr. 92, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ).

Në kushtet kur këto dy kandidatë kanë kandiduar në të pesta pozicionet e lira në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të hapura më datë 26.02.2020, ndërsa ligji kufizon të drejtën e kandidimit deri në tre pozicione (ref. neni 48/6 e ligjit për Statusin), ndërkohë që aplikimet e tyre janë konsideruar në procedurat e hapura për pozicionin e parë dhe të dytë të lirë (sipas Vendimeve nr.88 dhe nr.89, datë 26.02.2020), Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (KZHK), i ka kërkuar që të përcaktonin pozicionin e tretë të lirë për të cilin kandidonin (pozicionin e hapur me Vendimet nr. 90, nr. 91 apo nr. 92, datë 26.02.2020) dhe në përgjigje, zonja {...} është shprehur se ka aplikuar për pozicionin e tretë të lirë, hapur me Vendimin nr. 90, datë 26.02.2020. Ndërsa zonja {...} është shprehur se ka aplikuar për një pozicion të lirë, për ngritjen në detyrë në të njëjtën gjykatë, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe nuk ka kandiduar për më shumë se një pozicion të lirë për të bërë renditjen sipas preferencës.

Në rrethanat si më lart, KZHK i ka kërkuar një opinion ligjor Misionit EURALIUS në lidhje me këto çështje:

- i. qëllimi i kufizimit të mundësisë së kandidimit për ngritjen në detyrë në jo më

shumë se tre pozicione të lira ose pozicione që priten të bëhen të lira;

ii. tre pozicionet e lira për të cilat gjyqtari mund të kandidojë, nënkupton që ato mund të ishin edhe në të njëjtën gjykatë apo vetëm në tre gjykata të ndryshme?;

iii. renditja sipas preferencës në rast të kandidimit në më shumë se një pozicion të lirë sipas fjalisë së dytë, të pikës 6, të nenit 48, të ligjit për Statusin, a ishte përcaktuese edhe për kufizimin e mundësisë së kandidimit në jo më shumë se tre pozicione të lira sipas fjalisë së parë të pikës 6? Nëse jo, si duhej kuptuar dhe zbatuar rregulli sipas fjalisë së dytë, të pikës 6, të kësaj dispozite? A ishte korrekt interpretimi sipas të cilit fjalia e dytë, e pikës 6, nuk interferonte me rregullin sipas fjalisë së parë të pikës 6?

Sipas opinionit të EURALIUS, lidhur me interpretimin e pikës 6 të nenit 48 të ligjit për Statusin, ligji i referohet qartësisht një maksimumi prej tre pozicionesh, dhe jo gjykatash. Për shembull kandidati ka të drejtë të aplikojë për shembull për një pozicion të lirë në Gjykatën e Posaçme të Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe në dy pozicione të lira në Gjykatën e Lartë (në total tre pozicione). Në këtë rast kandidati rendit këto tre pozicione sipas preferencave. Ndërsa sa i përket kufizimit të mundësisë së kandidimit në jo më shumë se tre pozicione të lira ose që priten të bëhen të lira, EURALIUS, në opinionin e tij, shprehet se ligji ka si qëllim të shmangë vonesat gjatë procedurës së ngritjes në detyrë dhe nëse Këshilli do të shpallte shumë pozicione të lira, do të kishte shumë aplikantë në këto pozicione të lira dhe kjo të shkaktonte efekte negative si për shembull vonesa, pasi sa më shumë aplikime të ketë për një listë, aq më i gjatë do jetë procesi i vlerësimit.

Konsideratat juridike të dhëna në opinionin ligjor të Misionit EURALIUS janë të njëjta me ato të KZHK-së, pra se ligji përcakton qartësisht një maksimum prej tre pozicionesh, jo gjykatash, për kandidim për ngritjen në detyrë dhe se, në total, kandidatët mund të aplikojnë për jo më shumë se tre pozicione të lira ose që priten të bëhen të lira, ndërkohë që në rastin kur kandidati aplikon për më shumë se një pozicion, ai ka detyrimin të bëjë renditjen e pozicioneve sipas preferencave. Qëllimi i këtij kufizimi ligjor është shmangia e vonesave dhe e ndërlikimeve gjatë procedurës së ngritjes në detyrë.

Sa i përket kandidaturës së zonjës {...}, KZHK vlerëson se si pozicion i tretë për të cilin ka aplikuar kandidatja, të konsiderohet ai që i korrespondon procedurës së ngritjes

në detyrë të hapur me Vendimin nr.90, datë 26.02.2020. Gjithsesi KZHK vlerëson se duhet të jetë Këshilli që të vendosë mbi interpretimin dhe zbatimin e nenit 48/6 të ligjit për Statusin.

Këshilli ndan të njëjtin qëndrim me atë të Komisionit dhe e konsideron të ezauruar njoftimin e kandidatës znj. {...} për të përcaktuar pozicionin e tretë për të cilin kandidon, atëherë Këshilli mund të procedojë me shqyrtimin e projektvendimit të propozuar, i cili konsideron znj. {...} si kandidate për pozicionin e lirë që i korrespondon procedurës së ngritjes në detyrë të hapur me Vendimin nr.90, datë 26.02.2020. Në rast të kundërt, Këshilli mund të ftojë përsëri kandidaten për të përcaktuar në mënyrë të qartë pozicionin e tretë për të cilin kandidon, çka është shumë e rëndësishme, për shkak se përmes këtij përcaktimi, ajo do të përjashtohet automatikisht nga kandidimi në dy procedurat e hapura për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Gjithashtu zoti Toska parashton edhe lidhur me strukturën e projektvendimit, i cili përbëhet nga dy pika. Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 90, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në pikën e 2 të projektvendimit përcaktohet se për kandidatet znj. {...} dhe znj. {...}, të cilat kanë aplikuar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar edhe për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 88 dhe nr.89, datë 26.02.2020, si dhe për kandidaten znj. {...}, e cila ka aplikuar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar edhe për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 88, datë 26.02.2020, procedurat e verifikimit që janë në proces e sipër për këto kandidime, janë të vlefshme edhe për kandidimin e tyre për pozicionin e lirë të shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin nr. 90, datë 26.02.2020.

Diskutime/Komente/Pyetje/Propozime mbi çështjen

Çështjet që Këshilli duhet të diskutojë janë:

- 1) Interpretimi i pikës 6 të nenit 48 të ligjit për Statusin;

2) Bërja e një ftese tjetër për zonjën {...};

Mere fjalën **zonja Brikena Ukperaj** e cila ndan të njëjtin mendim me Komisionin sa i përket interpretimit të nenit 48/6 të ligjit për Statusin sipas të cilit kandidati nuk mund të kandidojë pas shpalljes së procedurës së ngritjes në detyrë në më shumë se 3 pozicione. Pyetja që zonja Ukperaj shtron është se sa do të jetë kohëzgjatja e këtij ndalimi sepse mund të ndodhë që pa mbaruar disa procedura të ngritjes në detyrë, Këshilli mund të hapë disa pozicione të tjera që mund të jenë në të njëjtën gjykatë. A do të jetë i ndaluar të kandidojë kandidati në këto pozicione të tjera të hapura? – është pyetja e zonjës Ukperaj. Të gjitha pozicionet e lira duhet të shpallen në të njëjtin moment dhe duhet të përfundojnë brenda 3 muajve nga momenti i shpalljes, me qëllim që ata që kandidojnë, të kenë mundësi që në një hap të dytë shpalljeje (pas 3 muajve), të kishin mundësi të aplikojnë, ndoshta në pozicione të njëjta që në fazën e parë nuk u kualifikuan.

Zoti Ilir Toska merr fjalën duke iu referuar nenit 48/2 ku Këshilli çdo tre muaj duhet të hapë një procedurë ngritjeje në detyrë për çdo pozicion të lirë. Duket sikur ligji parashikon mundësinë e disa raundeve të procedurave të ngritjes në detyrë që mund të hapen nga Këshilli në diferencë kohe prej 3 muajsh.

Raundin e parë të procedurave të ngritjes në detyrë për disa pozicione të lira janë hapur më datë 26 shkurt, ndërsa një raund të dytë të procedurave të ngritjes në detyrë mund të konsiderohen të hapën pas 3 muajsh dhe çdokush që mund të ketë kandiduar në procedurat e raundit të parë, mundet të kandidojë në raundin e dytë.

Sipas zotit Toska, ligji kufizon kandidimin në 3 pozicione të lira brenda të njëjtit raund.

Pyetjes së **zotit Maksim Qoku** që a mundet që një procedurë të mbyllet brenda 3 muajve apo nëse procedura e hapjes së këtyre pozicioneve zgjat më shumë se 3 muaj, a do të kenë mundësi këta kandidatë që janë në këto procedura të kandidojnë në pozicionet e tjera të lira që do të hapen? - **zoti Toska** i përgjigjet se praktikisht, referuar edhe procedurave që duhet të ndiqen, mundet që 3 muajt të kalojnë. Gjithashtu ligji nuk kufizon as afatet e kandidimit, që do të thotë që në raundin e dytë të mos konsiderohet

pengesë për kandidatët që kanë kandiduar në raundin e parë në pozicionet e lira, të kandidojnë sërish në pozicionet e lira në raundin e dytë, pavarësisht faktit që mund të mos jenë mbyllur procedurat në raundin e parë. I të njëjtit mendim është edhe **zonja Ukperaj**, që kandidatët nuk duhet të penalizohen/ndalohen nëse procedurat nuk mbyllen nga Këshilli brenda 3 muajve. Zonja Ukperaj është e mendimit që kur Këshilli të shpallë procedurat për ngritje në detyrë, të konsiderohet si një raund i parë dhe gjithashtu kandidatët të jenë ne dijeni që në këtë raund të parë ata nuk mund të konkurrojnë në më shumë se 3 pozicione.

Pyetjes së **zonjës Brunilda Kadi**, në lidhje me, nëse procedura për këto 5 pozicionet që janë hapur nuk përfundon brenda 3 muajve, që do të thotë që secili nga kandidatët që ka kandiduar (dhe Këshilli ia quan 3 pozicionet sipas ligjit), mbas kalimit të afatit 3 muaj, kanë të drejtë të bëjnë kërkesë sërish? – **zoti Toska** i përgjigjet se logjika e ligjit është që të bëjë hapje procedurash me raunde tremujore. Logjikisht, sipas situatës aktuale, një gjyqtar që kandidon në raundin e parë, nuk ka asnjë pengesë që të kandidojë edhe në raundin e dytë, pavarësisht se është mbyllur apo jo procedura e raundit të parë brenda 3 muajve.

Pyetjes tjetër të **zonjës Kadi** e cila e konkretizon duke u shprehur se aktualisht kanë kandiduar 4 kandidatë për 5 vende dhe vijon procedura për 3 pozicionet dhe 2 pozicionet e tjera ngelen pa kandidatë, pasi mund të ndodhë që të 4 kandidatët të kenë zgjedhur 3 pozicionet e para dhe pyetja konkrete e zonjës Kadi është se çfarë ndodh me 2 pozicionet e tjera të lira, do të rishpallen, do i jepet një afat tjetër, apo mund të rikandidojnë këto kandidatë meqë konsiderohet raund tjetër? - **zoti Toska** i përgjigjet se kandidatët që kanë aplikuar për 5 pozicionet e para të lira janë në proces, të paktën për 3 pozicione. Zoti Toska informon se ka përfunduar afati i kandidimit edhe për pozicionin e katërt dhe të pestë dhe kështu duhet që kandidatët të konsiderojnë nëse do të hyjnë në raundin e dytë. Praktikisht, në raundin e dytë, i vetmi pozicion që ka mbetur pa kandidat e që duhet të rihapet, është vetëm një, pozicioni i pestë i cili mund të hapet edhe pa përfunduar procedura për katër pozicionet e tjera.

Pyetjes vijuese të **zonjës Kadi** nëse njëri nga këto kandidatë që ka aplikuar tek 4 pozicionet e para të lira, ka të drejtë të kandidojë tek pozicioni i pestë edhe pse i bëhen 4 pozicione që konkurron, - **zoti Toska** i përgjigjet që ka të drejtë, pasi ligji kufizon kandidimin në 3 pozicione brenda të njëjtit raund dhe në një raund do të konsiderohen të gjitha pozicionet që shpallen në të njëjtën ditë, edhe pse afatet e kandidimit janë të ndryshme. Këshilli më datë 26 shkurt shpalli hapjen e procedurës së kandidimit për ato vende që konsideroheshin urgjente. Në nenin 48/2 ligji shprehet se Këshilli hap procedura për ngritje në detyrë çdo 3 muaj.

Më tej **zonja Kadi** shprehet se nëse do të interpretohet nga ana e Këshillit që të konsiderohen raunde sa herë që në një ditë të caktuar shpallen “x” vende, ndoshta kjo nuk do t’i penalizonte, përkundrazi, jep më shumë mundësi magjistratëve që të kandidonin në më shumë se 3 pozicione.

Ndërkohë **zonja Ukperaj** rimerr sërish fjalën për t’u shprehur se nuk mund të ketë më shumë se katër raunde procedurash për ngritje në detyrë brenda vitit. Por **zonja Kadi** është e mendimit se kjo nuk ka bazë ligjore dhe se shpallja mund të bëhet edhe çdo ditë, pasi ligji thotë “të paktën çdo 3 muaj”. Por **zonja Ukperaj** i përgjigjet që do të ketë probleme, pasi nëse do të rishpallen procedurat, nuk do të dijë Këshilli ku do të ndalohet kandidimi dhe ku s’do ndalohet. Nëse çdo rishpallje do të konsiderohet raund i dytë, nuk do të ketë sens ndalimi, pasi kandidati mund të mos kandidojë në raundin e parë dhe kandidon në raundin e dytë.

Rimerr fjalën sërish **zoti Toska** i cili është i mendimit që Këshilli duhet të konsiderojë raundet sa herë që ka shpallje procedurash për pozicione të lira dhe të vendosë në çdo raund të gjitha pozicionet e lira që janë për ngritjen në detyrë.

Lidhur me çështjen tjetër për diskutim, nëse i duhet bërë një ftesë e dytë zonjës {...} për të përcaktuar pozicionin e tretë, **zonja Ukperaj** është e mendimit që duhet të njoftohet mbi qëndrimin e Këshillit duke përcaktuar edhe pozicionin e tretë. I të njëjtit

mendim është edhe *zonja Kadi*, që të pyetet edhe një herë zonja {...} dhe t'i lihet një afat shumë i shkurtër për përgjigjen, në mënyrë që t'i jepet edhe një herë mundësi gjyqtares.

Hidhet në votim propozimi i bërë nga zonja Ukperaj dhe zonja Kadi mbi ftesën edhe një herë kandidates znj. {...}, për të përcaktuar në mënyrë të qartë pozicionin e tretë, brenda një afati shumë të shkurtër, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është kundër.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi që të ftojë përsëri kandidaten zonjën {...}, që brenda ditës së nesërme, të përcaktojë në mënyrë të qartë pozicionin e tretë për të cilin ajo kandidon.

Projektvendimi i propozuar në këtë pikë të rendit të ditës, do të shqyrtohet pasi të vijë përgjigjja nga kandidatja znj. {...}.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 28.05.2020)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 3 pozicione të lira.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 16:55.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Illir Toska* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
9. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, *zoti Dritan Hallunaj*.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 3 pozicione të lira.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Merr fjalën zoti Toska i cili lexon relacionin shpjegues mbi 3 projektvendimet “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për 1 pozicion të lirë”.

Ndër të tjera, në relacion parashtrohet se pas përfundimit të afateve për kandidimin në 4 pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 93, nr. 94, nr. 95 dhe nr. 96, datë 26.02.2020 (ndërsa pozicioni i pestë shpallur me vendimin nr. 97, datë 26.02.2020 nuk i ka përfunduar ende afati për të kandiduar), rezulton se për pozicionin e parë të lirë të hapur me Vendimin nr. 93, datë 26.02.2020, brenda afatit të kandidimit, pra deri më datë 29.04.2020, aplikoi një kandidat, ndërkohë që me Vendimin nr.153, datë 06.05.2020, Këshilli vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për kandidatin e vetëm për këtë pozicion, duke caktuar dhe relatorin përkatës.

Ndërkohë, në procedurat e tjera të ngritjes në detyrë, konkretisht në procedurën e dytë, të tretë dhe të katërt, të hapura me Vendimet nr. 94, nr. 95 dhe nr. 96, datë

26.02.2020, brenda afateve të kandidimit, që kanë përfunduar respektivisht më datë 06.05.2020, më datë 13.05.2020 dhe më datë 20.05.2020, nuk aplikoi asnjë kandidat. Në kushtet e moskandidimit të asnjë gjyqtari në këto 3 pozicione Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar tre projektvendime për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 3 pozicione të lira.

Sipas projektvendimeve të propozuara, Komisioni vlerëson që për secilën procedurë ngritjeje në detyrë, afati i kandidimit të jetë i ndryshëm, konkretisht:

Për procedurën e parë të rihapur afati i kandidimit të jetë deri më datë 10.06.2020.

Për procedurën e dytë të rihapur afati i kandidimit të jetë deri më datë 24.06.2020.

Për procedurën e tretë të rihapur afati i kandidimit të jetë deri më datë 08.07.2020.

Sa i përket përmbajtjes së projektvendimeve, ato janë strukturuar në 4 Krerë, me të njëjtën përmbajtje, me përjashtim të afatit të kandidimit, si dhe në rastin e hapjes fillimisht të procedurave për ngritjen në detyrë për këto pozicione të lira.

Bashkëlidhur projektvendimeve janë edhe dy formularët tip, që kandidatët duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë në momentin e aplikimit, konkretisht:

- i) formulari - Vetëdeklarim për masë disiplinore dhe;
- ii) formulari - Vetëdeklarim për situatën e papajtueshmërisë ambientale.

Diskutime/Komente/Pyetje/Propozime mbi çështjen

Zonja Brikena Ukperaj merr fjalën për t'u shprehur lidhur me afatet e kandidimit, pasi është e mendimit që nuk është e nevojshme që të lihen afate dyjavore të ndryshme por të lihet një afat për të tre pozicionet dhe ky afat të jetë 3-javor. Konkretisht, propozimi i zonjës Ukperaj konsiston që për të 3 pozicionet, afati i kandidimit të jetë i njëjtë.

Lidhur me përcaktimin e afateve të ndryshme është bërë për një arsye të vetme, - shprehet **zoti Ilir Toska**, pasi procesi i ngritjes në detyrë është i varur nga procesi dhe rezultatet e rivlerësimit kalimtar. Nga 5 procedurat e hapura në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë, kandidoi vetëm një gjyqtar, ndaj të cilit sapo kishte filluar procesi i rivlerësimit dhe kjo rrethanë e tillë bën që gjyqtarët të stepen. Mund të ndodhë që organet

e rivlerësimit të ecin me rivlerësimin edhe të gjyqtarëve të shkallës së parë dhe nga afatet e ndryshme, mund të vijnë kandidatë të mundshëm.

Megjithatë, zoti Toska shprehet se duke marrë shkas nga situata që është aktualisht gjyqësori, ka një kategori gjyqtarësh të shkallës së parë që janë në proces rivlerësimi, duke parë dhe prioritetin dhe urgjencën që ka plotësimi i pozicioneve të lira në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë, bën sens propozimi i zonjës Ukperaj, duke lënë një afat kandidimi 3-javor dhe pas përfundimit të afatit, nëse s'do të ketë kandidime, të rihapen sërish.

Hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i zonjës Ukeperaj, propozim i pranuar edhe nga relatori i çështjes, që afatet e kandidimit për rihapjen e tre pozicioneve të jetë i njëjtë, pra afat 3-javor, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është kundër.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi ndryshimin e bërë sipas propozimit të zonjës Ukperaj mbi afatin e kandidimit për secilin pozicion të rihapur, afat i cili do të jetë 3 javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë.

Hidhen në votim nga Kryetarja e Këshillit, projektvendimet në tërësi, bashkë me ndryshimin e miratuar pak më parë në lidhje me afatin e kandidimit i cili u miratua 3 javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të

njoftimit për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi 3 projektvendimet “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për 1 pozicion të lirë”.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 28.05.2020)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përmbushjen, nga kandidati, të kriterëve dhe kushteve të kandidimit, për t’u komanduar si pedagog i brendshëm, në Departamentin e Formimit Fillestar, të Shkollës së Magjistraturës”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 16:55.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Medi Bici** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli** (anëtare)
- 4. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 5. Ilir Toska** (anëtar)
- 6. Alban Toro** (anëtar)
- 7. Brikena Ukperaj** (anëtar)
- 8. Erjon Muharremaj** (anëtar)
- 9. Marçela Shehu** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Dritan Hallunaj**. Nuk mori pjesë në shqyrtimin e kësaj pike, **zoti Maksim Qoku**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 5. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.**

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përmbushjen, nga kandidati, të kriterëve dhe kushteve të kandidimit, për t’u komanduar si pedagog i brendshëm, në Departamentin e Formimit Fillestar, të Shkollës së Magjistraturës”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Relatore e kësaj çështjeje është zonja Marçela Shehu.

Merr fjalën zonja Marçela Shehu e cila lexon relacionin shpjegues mbi projektvendimin “Për përmbushjen, nga kandidati, të kriterëve dhe kushteve të kandidimit, për t’u komanduar si pedagog i brendshëm, në Departamentin e Formimit Fillestar, të Shkollës së Magjistraturës”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 99, datë 26.02.2020 ka shpallur hapjen e procedurës për paraqitjen e kërkesës nga kandidaturat që vijnë nga radhët e gjyqtarëve, për t’u komanduar, me pëlqimin e tyre, në pozicionin e pedagogut të brendshëm, në Departamentin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, procedurë e cila ka përfunduar më datë 29.04.2020 (afat i zgjatur me vendimin nr. 142, datë 22.04.2020). Pas përfundimit të afatit, rezultoi të ketë paraqitur kërkesë vetëm 1 kandidat, konkretisht gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë znj. {...}.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vlerësuar se komandimi i gjyqtarës {...} në Shkollën e Magjistraturës nuk cenon funksionalitetin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku gjyqtarja ushtron detyrën, prandaj me vendimin nr. 159, datë 15.05.2020, ka vendosur miratimin e opinionit për kandidaten në fjalë dhe publikimin e këtij opinionit në faqen zyrtare të KLGJ-së.

Ligji parashikon gjithashtu që kandidatët, që vijnë nga radhët e gjyqtarëve, për t'u komanduar në pozicionin e pedagogut të brendshëm, në Departamentin e Formimit Fillestar, të Shkollës së Magjistraturës, duhet të përmbushin disa kriterë, të përgjithshme dhe të veçanta, kushte këto që përcaktohen në ligjin 96/2016 dhe ligjin 115/2016, ndaj bazuar në dokumentacionin e dosjes personale të kandidatës të administruar pranë Këshillit ka rezultuar se: Komandimi i saj nuk vjen ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku ushtron funksionin e gjyqtarit; Kandidatja nuk është në një pozicion me mandat të kufizuar; Kandidatja nuk ka qenë dhe nuk është e komanduar; Kandidatja nuk ka asnjë masë disiplinore në fuqi; Kandidatja plotëson kriterin e eksperiencës në punë si gjyqtar, mbi 10 vjet, nga data 04.09.1999 dhe në vazhdim; ndërsa lidhur me kriterin e eksperiencës së mësimdhënies, ai kryhet nga Shkolla e Magjistraturës, sipas Rregullores së Brendshme të miratuar nga Shkolla.

Bazuar sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor:

Të shprehet lidhur me verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve për komandim (përveç kriterit të mësimdhënies që do të vlerësohet nga Shkolla e Magjistraturës), të kandidatës, gjyqtarës {...}, e cila ka aplikuar për t'u komanduar, në pozicionin e pedagogut të brendshëm, në Departamentin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës si dhe t'i dërgojë emrin e gjyqtarës {...} Shkollës së Magjistraturës së bashku me praktikën dokumentare të paraqitur prej saj dhe Opinionin e Këshillit të Lartë Gjyqësor lidhur me këtë kandidatë.

Diskutime/Komente/Pyetje/Propozime mbi çështjen

Zonja Brikena Ukperaj merr fjalën për të sugjeruar heqjen e termit “Verifikim” në pikën e parë të projektvendimit dhe fjalë të jetë: “... Vendosi: 1. Plotësimin e kushteve dhe kriterëve për komandim...”, pasi verifikimi është procesi që kryen Këshilli dhe ajo që

Këshilli vendos është plotësimin e kushteve. Pra verifikimi i kushteve është bërë dhe se Këshilli tashmë duhet të vendosë plotësimin e këtyre kushteve dhe kriterëve.

Ndërsa *zonja Brunilda Kadi* është e mendimit që nuk kanë kuptim fjalët “Vendosi plotësimin e kriterëve”, pasi kandidatja është ajo që plotëson kriteret dhe jo Këshilli. Këshilli bën verifikim, ndërsa kushtet dhe kriteret i plotëson kandidatja.

Për ta përmbyllur, merr fjalën *zonja Marçela Shehu* e cila sugjeron që termi i duhur mund të jetë “Konstatim” në vend të termit “Verifikim”, pra të bëhet “...Këshilli vendosi: Konstatimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve për komandim...”. Këtij propozimi i bashkohen edhe zonja Ukperaj e cila heq dorë nga propozimi i saj, edhe zoti Toska.

Hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i bërë nga zonja Shehu dhe i pranuar nga zonja Ukperaj dhe zoti Toska, për zëvendësimin në pikën e parë të projektvendimit të termit “Verifikimin” me termin “Konstatimin”, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Brunilda Kadi është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: 1. Konstatimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve për komandim (përveç kriterit të mësimdhënies që do të vlerësohet nga Shkolla e Magjistraturës), të kandidatës, gjyqtarës {...}, e cila ka aplikuar

për t'u komanduar, në pozicionin e pedagogut të brendshëm, në Departamentin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës.

2. Dërgimin e emrit të gjyqtares {...} Shkollës së Magjistraturës së bashku me praktikën dokumentare të paraqitur prej saj dhe Opinionin e Këshillit të Lartë Gjyqësor lidhur me këtë kandidate.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 28.05.2020)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për pezullimin e procedurave të lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë, emërimit të punonjësve të gjykatave, statusi i të cilëve rregullohet nga Ligji nr.98/2016 “Për organizmin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, propozim i disa anëtarëve.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 16:55.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Ilir Toska*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, *zoti Dritan Hallunaj*.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për pezullimin e procedurave të lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë, emërimit të punonjësve të gjykatave, statusi i të cilëve rregullohet nga Ligji nr.98/2016 “Për organizmin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, propozim i disa anëtarëve.

Ky projekt-akt vjen si propozim i disa anëtarëve dhe konkretisht z. Maksim Qoku, znj. Marçela Shehu, znj. Brunilda Kadi, znj. Fatmira Luli, z. Alban Toro dhe z. Medi Bici.

Merr fjalën *zonja Marçela Shehu* fillimisht e cila bën një relativitet të shkurtër sa i përket projektvendimit të propozuar mbledhjes plenare “Për pezullimin e procedurave të lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë, emërimit të punonjësve të gjykatave, statusi i të cilëve rregullohet nga Ligji nr.98/2016 “Për organizmin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Zonja Shehu shprehet se ashtu siç është komunikuar edhe nëpërmjet e-mailit, pas konstatimit në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, se kjo gjykatë kishte në proces që në datë 17.02.2020 disa procedura për lëvizje paralele, për ngritje në detyrë dhe për emërim të punonjësve civilë gjyqësor, vetë zonja Shehu ka vënë në dijeni anëtarët e Këshillit duke kërkuar që të njoftohet Gjykata e Lartë që të pezullojë këto procedura, duke qenë se

ato vijnë në kundërshtim me nenin 54 e vijues të ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”. Pas këtij komunikimi, shumica e anëtarëve ranë dakord që t’u kërkohej (jo vetëm Gjykatës së Lartë) të gjitha gjykatave që kishin realizuar procedura të tilla, që t’i pezullonin ato. Ndaj edhe 6 prej anëtarëve kanë kërkuar thirrjen e mbledhjes plenare për të miratuar atë që në fakt anëtarët kishin dakordësuar, pra pezullimin e procedurave që gjykatat kanë nisur për lëvizjet paralele dhe ngritje në detyrë.

Ligji 98/2016 në nenet 54 e vijues, rregullohen juridikisht të gjitha procedurat që duhet të ndjekë Këshilli i Lartë Gjyqësor, këshillat e gjykatave, lidhur me procedurat e pranimit në shërbimin civil gjyqësor në lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë, të nëpunësve civilë gjyqësorë. Rezulton se Gjykata e Lartë (janë për t’u verifikuar edhe gjykatat e tjera), ka realizuar procedurat e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit në shërbimin civil gjyqësor, në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e parashikuara në nenin 98/2016, kjo për shkak se referuar nenit 84 dhe 85 të ligjit 98/2016, KLGJ dhe këshillat e gjykatës nuk mund të bëjnë pranime në shërbimin civil gjyqësor, ngritje në detyrë apo lëvizje paralele, pa u bërë konfirmimi i statusit të nëpunësit civil gjyqësor të punonjësve aktual që vijojnë punën pranë gjykatave. Këto procedura nuk mund të realizohen pa nxjerrë KLGJ aktet nënligjore përkatëse, ashtu siç e kërkon neni 84/6, neni 85/6, neni 54/7, neni 57/13, neni 58/6 të ligjit 98/2016, si dhe procesi fillimisht duhet të orientohet nga KLGJ e cila sipas nenit 57 dhe 90 të ligjit 115/2016, publikon dhe shpall konkurrim të hapur për vendet e lira në shërbimin civil gjyqësor si dhe fillimin e procedurave për ngritjen në detyrë dhe lëvizjen paralele dhe më pas këshillat e gjykatës kanë kompetencë të bëjnë veprimet e tjera lidhur me punonjësit civilë gjyqësorë, emërimi i të cilëve bëhet nga këshillat e gjykatave.

Më tej zonja Shehu shprehet se me konstatimin e mosrespektimit të këtyre procedurave që kërkon ligji, por duke konstatuar edhe faktin që KLGJ ende nuk ka nxjerrë aktet nënligjore që ligji e ka ngarkuar, anëtarët propozues të aktit propozojnë që për sa kohë këto akte nënligjore nuk kanë dalë, të pezullohet çdo veprim tjetër që ndjekin gjykatat sot për lëvizjet paralele, ngritjet në detyrë apo për emërimet e të gjithë atyre punonjësve, statusi i të cilëve do duhet të rregullohet nga ligji 98/2016, ku nuk përfshihen punonjësit që rregullohen me Kodin e Punës.

Merr fjalën më pas *zoti Maksim Qoku* si një nga propozuesit e projekt-aktit i cili kërkon të vë në dukje një problematikë që ka dalë nga mbledhja e kryetarëve, mbledhje e shtatorit 2019 ku ka qenë prezent edhe zoti Toro dhe zonja Kadi, është folur në pikën e tretë për problemin e rekrutimeve (sidomos për sekretaret gjyqësore, IT-të, ftuesve). Zoti Qoku shprehet se ka kontaktuar me kryetarët e gjykatave në lidhje me trajtimin e kësaj situatë. Këshilli është përpara një gjendjeje juridike që ligji ngarkon por edhe përpara një situatë faktike, ku aktet nënligjore mungojnë. Sa i përket takimit të 27 shtatorit të kryetarëve të gjykatave, zoti Qoku shprehet se është konkluduar që të vazhdohet me rekrutimet sipas sistemit të vjetër, duke u marrë parasysh, për aq sa është e mundur, kriteret e përcaktuara nga ligji 98/2016, por ndërkohë të operohej me emërimin me afatin 1-vjeçar, bazuar në Kodin e Punës.

Pezullimi i emërimeve kundërshtohet nga kryetarët, pasi sot është luks pasja e një burimi njerëzor në gjykata për shkak të nevojave të tyre dhe përveçse ka 1 vit e gjysmë që këto procedura janë bërë, ato aktualisht kanë nxjerrë njoftime dhe janë përsëri në proces emërimesh, sidomos të sekretareve gjyqësore. Kështu që, -shton zoti Qoku, mosveprimi i KLGJ-së për miratimin e akteve nënligjore, mundet që në efekt negativ të shtrihet në gjykatat të cilat mund të penalizohen nga një vendim pezullimi.

Kështu, sipas zotit Qoku, të ndahet aspekti i lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë nga procesi i emërimit, pasi gjykatat janë përqendruar tek emërimet, ku aspektin ligjor e kanë mbështetur tek Kodi i Punës. Gjithashtu zoti Qoku kërkon që të ndahet nga debati vonesa që ka shkaktuar mosmiratimi i akteve nënligjore (përgjegjësi e KLGJ-së) nga procesi i nevojshëm që është për gjykatat në lidhje me emërimet që kanë ato për burimet njerëzore. Nga njëra anë KLGJ-ja ka miratuar organikat e këtyre gjykatave dhe ka përcaktuar edhe vendet nëpër gjykata dhe nga ana tjetër nuk ka përcaktuar aktet nënligjore që bëjnë këto rregullime.

Ajo që është e rëndësishme është edhe fakti që duhet parë edhe autoriteti i KLGJ-së në situatën kur në mosmiratim të akteve nënligjore nuk ka një regjistër ku të shënohen nëpunësit civilë gjyqësorë dhe aq më tepër që nuk ka një analizë të kriterëve për ato burime njerëzore që i plotësojnë për të marrë këtë status dhe të jenë të konfirmuar nga KLGJ-ja dhe kjo, sipas qëndrimit të pjesës më të madhe të kryetarëve të gjykatave, e bën

të pamundur KLGJ-në që të ketë autoritet në këtë fazë. Në përfundim, zoti Qoku shprehet që KLGJ të ketë parasysh situatën faktike nga ajo juridike.

Zonja Brunilda Kadi merr më tej fjalën në referim të çka tha zoti Qoku sa i përket mbledhjes së kryetarëve ku prezent kanë qenë zoti Qoku, zoti Toro dhe vetë zonja Kadi, bën me dije se aty janë vënë në dijeni për shumë komunikime në emër të Këshillit që dërgoheshin nga një adresë që nuk dihej se çfarë ishte, ose dërgoheshin nga Sekretari i Përgjithshëm ose nga zonja Laze apo nga dikush tjetër dhe që flitej në emër të Këshillit.

Së dyti, zonja Kadi i referohet gjithashtu faktit që në një nga mbledhjet me kryetarët e gjykatave është rënë dakord që të vazhdohet me këto rekrutime sipas ligjit të vjetër dhe shprehet se mbledhja e kryetarëve nuk ka asnjë kompetencë ligjore që të marrë këto lloj vendimesh dhe këtë kompetencë e ka vetëm Këshilli, i cili vepron me vendime dhe me akte, pasi është organ administrativ.

Ndërsa sa i përket diskutimit të zotit Qoku në lidhje me faktin, e janë të shqetësuar ndoshta kryetarët që kanë probleme me punonjësit, zonja Kadi shprehet se shprehet se nuk është problem mospasja e sekretareve gjyqësore në gjykata dhe jep shembull Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku zonja Kadi është gjyqtare, e cila ka suficiencë me sekretare gjyqësore, si dhe gjithashtu një pjesë e mirë e gjyqtarëve sot janë jashtë gjykimeve, prandaj dhe nuk kanë nevojë gjykatat për sekretare gjyqësore. Por edhe sikur të ishte e vërtetë, nuk mendon që një situatë faktike, sidomos pas 1 viti e gjysmë që Këshilli ekziston, të thuhet meqë është shkelur deri tani ligji, të vazhdohet ta shkelet. Prandaj, zonja Kadi, propozon që pasi të merret ky vendim për pezullimin e këtyre procedurave, të kërkohet një informacion nga të gjithë gjykatat për të gjitha emërimet që janë bërë sipas ligjit për Statusin apo ligjin për Statusin e nëpunësit civil, pasi për zonjën Kadi si juriste, këto veprime janë qartazi të pavlefshme. Prandaj t'i kërkohet të gjithë gjykatave, duke konsideruar këto veprime të pavlefshme, të vijojnë procedurat sipas ligjit dhe ndërkohë Këshilli që është përgjegjës, të miratojë me urgjencë aktet nënligjore.

Sipas zonjës Kadi, nuk është problem shqetësimi i kryetarëve të gjykatave, pasi nëse do të kishin një problem, ata duhet ta përcillnin në Këshill. Nëse e kanë sjellë dhe u është kthyer përgjigje nga Këshilli në emër të organeve të pidentifikuara dhe që s'kanë lidhje me Këshillin, atëherë, ai që ka kthyer përgjigje të mbajë përgjegjësi, pasi herë pas

here u është dërguar informacion apo u janë dhënë urdhra (apo komunikime) kryetarëve në detyrë/zëvendëskryetarëve nga një adresë e-maili që quhet “kontakt.klgj”, që pas informacionit të marrë, është kabineti. Kjo është e kundraligjshme, -sipas zonjës Kadi, pasi është njësoj si këshilltarët e Njësisë Mbështetëse të Komisioneve që të komunikojnë në emër të Këshillit me magjistratët.

Në përfundim, zonja Kadi shprehet se të gjitha emërimet që janë bërë në kundërshtim me ligjin janë të cenueshme juridikisht dhe sjellin pasoja. Prandaj e ripërsërit edhe një herë propozimin e ardhur në Këshill për pezullimin e procedurave duke i kërkuar të gjithë gjykatave të marrin masat për t’i shpallur absolutisht të pavlefshme të gjitha emërimet që janë bërë dhe të fillojnë procedurat sipas ligjit.

Një tjetër anëtar iniciues i këtij projektvendimi është edhe **zoti Medi Bici** i cili shprehet se nuk ka pasur dijeni për çka është diskutuar në mbledhjen e kryetarëve të gjykatave dhe që ata e kanë ngritur si shqetësim dhe kanë dhënë udhëzim për t’u zbatuar Kodi i Punës për këto raste, gjithashtu as dijeni për aktet nënligjore që duhen dhe pse nuk kanë vazhduar procedurat për miratimin e tyre.

Sa i përket emërimeve të kryera në gjykata, zoti Bici shprehet mbi shqetësimin e tij, sipas të dhënave që ka, ku në këto emërimet po shkelet hapur neni 8 i ligjit 96/2016 për statusin ku flitet mbi papajtueshmërinë ambientale, duke u emëruar njerëz të të njëjtës familje, apo kushërinj të parë, gjë që do të ishte shqetësuese për Këshillin kur të dalin këto fakte.

Zoti Bici propozon që Këshilli duhet të vihet menjëherë në lëvizje për të miratuar aktet nënligjore dhe emërimet të bëhen sipas nenit 57 të ligjit 98/2016.

Merr fjalën propozuesi tjetër i projekt-aktit, **zoti Alban Toro**, i cili shprehet se po t’i referohesh shpalljeve që ka bërë Gjykata e Lartë për konkurrimet për ngritjet në detyrë dhe lëvizjet paralele, dhe lexon dy nga shpalljet e saj, ku si referenca ligjore ka përdorur nenet 9, 56 dhe 57 i ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, ku janë një sërë procedurash të kryera nga kryetari në detyrë, detyra e të cilit, çdo organi administrativ, fillimisht është verifikimi i kompetencës sepse ligji e ka parashikuar që çdo organ ka të drejtën dhe detyrën të ushtrojë kompetencën në atë pjesë legislative që i takon. Në bazë

të legjislacionit aktual, një pjesë e kompetencave të ushtruara aktualisht, i takojnë KLGJ-së. Prandaj dhe është kërkuar nga zoti Toro që për këtë kryetar në detyrë, Këshilli të shprehej për mbarimin e ushtrimit të detyrës së tij sepse këto janë risqet që sjell qëndrimi, tej çdo shkakut të arsyeshëm, në detyrë, të një personi që është pa mandat. Prandaj, edhe zoti Toro propozon që të pezullohen këto procedura; të verifikohen të gjitha procedurat që janë ndjekur dhe të konkludohet pastaj nga ana e Këshillit se si do të veprohet, për të rregulluar edhe pasojat (nëse do të ketë).

Rimerr fjalën **zonja Shehu** për të bërë një sqarim lidhur me atë çka tha zoti Qoku mbi lëvizjet paralele, ngritjet në detyrë dhe mosqenia kundër për emërimet në detyrë. Në referim, zonja Shehu përmend nenin 58 të ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” i cili flet për emërimin në shërbimin civil gjyqësor e lidh në mënyrë të detyrueshme këtë proces me përfundimit të procesit të lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë. Pra Këshilli nuk mund të jetë kundër lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë dhe të jetë pro pranimit në shërbimin civil, pasi janë faza që janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën.

Ndërsa lidhur me shqetësimin tjetër, që zëvendëskryetarët janë të shqetësuar që po u pengohet puna, zonja Shehu rikujton që gjykatat janë pa gjyqtarë, Gjykata e Lartë është pothuajse jashtë funksionit sa i përket gjykimeve dhe nuk po vihet në funksion, pasi Këshilli ka qenë i përgjegjshëm maksimalisht që të konkludojë me të gjitha aktet nënligjore përkatëse, që të gjitha procedurat, si të lëvizjes paralele dhe si të ngritjes në detyrë, të bëheshin konform ligjit.

Funksionaliteti i të gjitha gjykatave, si për sa i përket emërimit të gjyqtarëve, ashtu edhe sa i përket pranimit në shërbimin civil gjyqësor të punonjësve të tjerë apo atyre me kontratë, të bëhen në përputhje me ligjin dhe me të gjitha aktet nënligjore që duhet të nxjerrë KLGJ. Është përgjegjësi e Këshillit dhe e gjykatave që të zbatojnë ligjin, me qëllim që të gjitha emërimet të bëhen në përputhje me ligjin.

Merr fjalën më pas **zonja Brikena Ukperaj** e cila është dakord me analizën ligjore që bën zonja Shehu dhe mendon që në momentin kur do të fillojë rekrutimi i nëpunësve gjyqësorë civilë, duhet të zbatohen të gjitha këto procedura. Situata faktike sot nuk përputhet me situatën ligjore sepse Këshilli ka 1 vit e gjysmë i krijuar dhe ende nuk ka

aktet që rregullojnë statusin e nëpunësit civil. Për sa kohë që Këshilli nuk i ka këto akte, asnjë rekrutim që ka ndodhur apo që do ndodhë deri kur të miratohen këto akte, nuk quhet rekrutim në shërbimin gjyqësor civil, pavarësisht emrit që mund t'i vërë këshilli i gjykatës apo kryetari i gjykatës.

Më tej zonja Ukperaj shton që nevojat për funksionalitetin e gjykatave, ka detyruar Këshillin që të miratojmë 120 punonjës shtesë në organikat e gjykatave, në pozicione të tilla që sot kategorizohen si nëpunës gjyqësorë civilë në ligj. Këshilli e dinte që nuk kishte këto aktet dhe nuk u ngrit fare si shqetësim. Në mungesë të këtyre akteve, këshillat e gjykatave kanë operuar duke rekrutuar punonjës, duke respektuar për aq sa është e mundur ligjin, pa iu dhënë statusin e nëpunësit gjyqësor civil. Asnjë rekrutim sot nuk ka statusin e nëpunësit gjyqësor civil asnjë punonjësi.

Pas shqetësimi të ngritur nga zonja Shehu për rekrutimet në Gjykatën e Lartë dhe pas këqyrjes së faqes së internetit të gjykatës, rezultoi se gjykata kishte ndjekur një miks procedurash duke vendosur në titull ose në bazë ligjore dispozita të ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, por që në fakt i referoheshin ligjit “Për statusin e nëpunësit civil”. Aktet ishin të një sektori të Burimeve Njerëzore për mënyrën sesi vepron DAP-i dhe jo të kryetarit të gjykatës në detyrë.

Çështja që shtrohet është nëse ka një vizion Këshilli se si do të zgjidhë çështjen, pasi Këshilli ka miratuar 120 punonjës që duhet t'u shtohen organikave të gjykatave dhe përveç këtyre mund të jenë bërë emërimet edhe në vende vakante që janë krijuar, apo emërimet nga pozicioni sekretar në kryesekretar (që është ngritje në detyrë). Këshilli nuk ka një informacion nga gjykatat për të dalë më pas me një vendim pezullimi. Gjithashtu, duke mos pasur aktet përkatëse, - shton zonja Ukperaj, Këshilli nuk mund të bëjë dot as shpalljen e lëvizjes paralele dhe situata në gjykata do të ngrijë. Nga momenti që është lejuar dhe asnjë prej tyre nuk ka statusin e nëpunësit gjyqësor civil.

Zonja Kadi i drejton pyetjen zonjës Ukperaj se çfarë lidhje ka miratimi i organikës me pezullimin e këtyre procedurave, meqenëse zonja Ukperaj iu referua miratimit të shpërndarjes me 120 punonjës nëpër gjykata. Megjithatë, vizioni i *zonjës Ukperaj* (meqenëse pyetet nga zonja Kadi për vizionin e saj) është që Këshilli sot duhet të kishte një akt nënligjor për t'u miratuar e jo të flitej për pezullimin e këtyre

procedurave në gjykata. Sot nuk ka një regjistër, nuk ka një listë për të bërë shpallje të lëvizjes paralele dhe e gjithë kjo situatë do të bllokonte gjykatat, -shton zonja Ukperaj. Nëse do pritej që Këshilli të bënte aktet nënligjore, asnjë gjykatë nuk do bënte dot rekrutime, prandaj sipas zonjës Ukperaj, nuk është zgjidhje pezullimi si masë drastike në këtë moment, por zgjidhja është që Këshilli të bëjë aktet nënligjore edhe brenda javës.

Zonja Kadi i drejton sërish një pyetje zonjës Ukperaj mbi çfarë do bëhet me emërimet që janë bërë në mënyrë të paligjshme, pasi një jurist s'mund të thotë që emërimi si nëpunës civil, në kundërshtim me procedurën, nga organ i paidentifikuar, nuk është absolutisht i pavlefshëm.

Zonja Ukperaj i përgjigjet që për zonjën Kadi mund të jetë e paligjshme e për dikë tjetër nuk është e paligjshme. Marrëdhëniet e punës në gjykata vazhdon të rregullohen nga kontratat e punës.

Sipas zonjës Ukperaj, nuk mund të pezullohet çdo gjë derisa Këshilli të nxjerrë aktet nënligjore. Përgjegjësia e Këshillit është të nxjerrë aktet nënligjore dhe të rregullohet situata dhe Këshilli i Gjykatës, në momentin që do të verifikojë statusin e çdo të punësuarit në gjykatë, sipas kategorisë që ka, t'i marrë parasysh të gjitha parashikimet, edhe ato të papajtueshmërisë ambientale. Nëse kjo nuk ndodh, ai sistemohet në një pozicion tjetër. Çdokush në gjykata sot, duhet t'i nënshtrohet procedurës së verifikimit nga Këshilli i Gjykatës.

Rimerr fjalën **zonja Kadi**, duke bërë pyetjen se kush i ka lejuar ata që ta bëjnë këtë gjë? Dhe i drejtohet gjithashtu zonjës Ukperaj nëse i ka kthyer ndonjë përgjigje zyrtare në emër të Këshillit. Në përgjigje, **zonja Ukperaj** shprehet sigurisht që nuk ka i kthyer përgjigje zyrtare askujt, por me mosveprim dhe miratim organikash është lejuar, pasi kryetarët kanë ngritur edhe në mbledhjen e kryetarëve këtë problem dhe më pas kanë arritur bashkërisht në konkluzion.

Pyetjes së **zonjës Kadi** mbi mbledhjes e kryetarëve, nëse kanë ndonjë tagër, zonja Ukperaj i përgjigjet se ata kanë unifikuar praktikat e rekrutimit me njëri-tjetrin dhe më tej

në përgjigje të kësaj, zonja Kadi shprehet se ata nuk kanë asnjë kompetencë. Sipas zonjës Kadi, është haptazi, absolutisht e pavlefshme dhe nuk ka asnjë rrethanë që mund të kurojë këtë pavlefshmëri. Ndërsa mbi propozimin e zonjës Ukperaj që Këshilli i rregullon mbrapa, ato që certifikohen mbrapa, janë ato nëpunës që kanë ekzistuar përpara se të hynte në fuqi ligji. Fakti që Komisioni përgjegjës nuk ka vepruar për 1 vit e gjysmë për të nxjerrë aktet nënligjore, kjo nuk mund të jetë përgjegjësia e saj, -shton zonja Kadi. Si anëtare e Këshillit, zonja Kadi nuk ka informacion që janë bërë emërimet nëpër gjykata në kundërshtim me ligjin. Le të mbahet përgjegjësia nga ata që e kanë lejuar, -vijon zonja Kadi. Në momentin që u konstatua, duhet të ndërpritet, pasi do ketë pasoja ligjore, prandaj të çbëhen të gjitha ato veprime që janë në kundërshtim me ligjin, pasi pavlefshmëria absolute (në rastet kur e gjithë procedura është shkelur dhe është bërë nga një organ jo kompetent) është pavlefshme që nuk shërohet asnjëherë.

Sa i përket qëndrimit të saj, **zonja Ukperaj** shprehet se mban qëndrim të ndryshëm nga zonja Kadi sepse në thelb vlerëson që asnjë nga këta të punësuar nuk është nëpunës gjyqësor civil. Statusin e marrin në bazë të ligjit, kur Këshilli të miratojë aktet nënligjore. Sipas saj, sot asnjë gjykatë nuk bën dot procedurë rekrutimi të nëpunësit gjyqësor civil sepse i mungojnë aktet (nuk ka listë për të bërë verifikimin). Ndërkohë, pyetjes së zonjës Kadi mbi si do e marrin statusin këta punonjës, zonja Ukperaj e rithekson se statusin e marrin pasi të bëhet verifikimi nga Këshilli i Gjykatave, ashtu siç do ta marri edhe ish i punësuar. Ndërsa pyetjes tjetër të zonjës Kadi mbi nëse do të kishte qenë dikush tjetër dhe të ishin zbatuar procedurat ligjore, si shkelet e drejta e atij që kandidon, zonja Ukperaj i përgjigjet duke shtuar se sot nuk zbatohen dot procedurat ligjore sepse nuk ka akte nënligjore që të përcaktojnë mënyrën sesi do të ndërtohet lista.

Ndërkohë **zonja Kadi** pyet gjithashtu pse nuk bëhen edhe emërimet e gjyqtarëve pa akte nënligjore dhe të rregullohen më mbrapa pastaj? Pse duhet të ndjekë Këshilli dy standarde?

Zonja Ukperaj i drejton një pyetje zonjës Kadi mbi si do t'i rekrutonin gjykatat punonjësit në këto 1 vit e gjysmë?

Zonja Kadi nuk disponon informacion mbi këtë shqetësim që mund të kanë gjykatat, shqetësim që duhet ta kishin sjellë në Këshill. Zonja Kadi shprehet se nuk ka transparencë në Këshill si me të tretët ashtu edhe me anëtarët si dhe për çka nuk ka informacion, nuk mund të mbajë përgjegjësi.

Zonja Ukperaj në përgjigje shprehet se përgjegjësia është e të gjithëve dhe se në momentin që zonja Kadi ka marrë dijëni në mbledhjen e kryetarëve, duhet ta bënte dijëni në Këshill.

Zonja Kadi shprehet se në mbledhjen e kryetarëve është informuar mbi faktin që magjistratët dhe kryetarët komunikojnë me administratën e Këshillit, ndërkohë që anëtarët e Këshillit (anëtarët pjesëmarrës në mbledhje) nuk kishin dijëni.

Zonja Ukperaj shkëput një fjali nga procesverbali i mbledhjes së kryetarëve të gjykatave datë 27 shtator 2019, ku është ngritur problemi i rekrutimit në gjykata, ku zonja Kadi është shprehur: “Kjo është çështje e Komisionit të Planifikimit Strategjik i cili duhet të angazhohet maksimalisht dhe të vijë me propozimet përkatëse”.

Pas diskutimeve të zonjës Kadi dhe zonjës Ukperaj, merr fjalën **zonja Fatmira Luli**, si një nga anëtarët propozues të projekt-aktit, e cila thekson se kjo është një paligjshmëri që s’mund të justifikohet me asnjë nevojë që ka gjykata, ndaj mendon që është urgjente situata e pezullimit të këtyre procedurave dhe marrja e informacionit për të gjithë këto emëtime. Ligji ka parashikuar në mënyrë të qartë që të gjitha këto pozicione në gjykatat e rretheve, gjykatat e apeleve dhe në Gjykatën e Lartë janë në kategoritë e nëpunësve civilë të përcaktuar në nenin 50. Të gjithë këto kategori duhet të kenë statusin e nëpunësit civil në bazë të ligjit për shërbimin civil që Këshilli duhet të miratojë dhe të gjitha këto procedura duhet të nisnin nga Këshilli me akte nënligjore. S’mund të ketë justifikim që të vazhdohet me paligjshmëri dhe duke thënë që s’ka akte nënligjore. Këshilli të ulet të miratojë aktet nënligjore dhe të vazhdojë sipas ligjit procedurat edhe për ato që janë punësuar dhe të shpallen dhe të konsiderohen që kanë qenë me kontratë të

përkohshme pune dhe të fillohen procedurat e parashikuara në ligj. Prandaj edhe zonja Fatmira Luli mbështet kërkesën dhe të votohet nga ky Këshill pezullimi i këtyre procedurave, marrja e informacionit dhe miratimin me urgjencë të akteve nënligjore për t'i bërë të ligjshme këto procedura.

Më tej merr fjalën **zoti Erjon Muharremaj**, i cili në vijim edhe të informacioneve të marra nga diskutimet e bëra të zotit Qoku dhe zotit Bici, shprehet se është në pamundësi të marrë një vendim sot pa pasur një informacion të detajuar nga kryetarët në detyrë të secilës nga gjykatat. Ndaj zoti Muharremaj propozon që Këshilli t'u drejtohet të gjithë kryetarëve në detyrë të gjykatave që të japin një informacion të hollësishëm në lidhje me rekrutimet e kryera dhe situatën e papajtueshmërisë ambientale që ngriti zoti Bici në fjalën e tij, që më pas të arrihet në një vendimmarrje.

Zonja Kadi shprehet në vijim të fjalës së zotit Muharremaj se papajtueshmëria ambientale është moment pasi të legjitimohet procedura, pra që i përket themelit dhe kur të hyhet në procedurën normale/ligjore mund të diskutohet për këto gjëra.

Ndërkohë i përgjigjet zotit Muharremaj se mungesa e informacionit duhet të jetë një argument më shumë që të kërkohet pezullimi sepse nëse nga informacioni del më pas që paligjshmëria është ekstreme, çfarë do të ndodhë me mungesën e pezullimit?

Zotit Muharremaj, rithekson se në kushtet e mungesës së informacionit dhe në kushtet e detyrimit që ka Këshilli, referuar pikës 1 të nenit 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku detyrimi është që të garantohet mbarëvajtja e veprimtarisë gjyqësore, me informacionin e disponuar, zoti Muharremaj është në pamundësi për të dalë me një qëndrim përfundimtar pa pasur një informacion të hollësishëm nga kryetarët në detyrë të gjykatave dhe vetëm pasi të vijë ky informacion, do mund të dalë me një qëndrim të tijin.

Rimerr fjalën **zoti Alban Toro**, i cili në referim të asaj çka tha zonja Ukperaj, konstaton se ka akoma më shumë shkaqe për të pezulluar veprimet që ka kryer Gjykata e Lartë. Nuk mund të thuhet që aty ka një sektor personeli që ka vendosur dhe ka dalë të

konfliktohet me KLGJ-në në raport me kompetencat që kjo e fundit ka në këtë procedurë. Sipas nenit 37, kryetari i gjykatës është ai që përfaqëson me të tretët gjykatën, kështu që mbase ka ngarkuar sektorin e personelit për të bërë këto materiale, që ka marrë përsipër të vendosë në bazën ligjore nenin 56 dhe 57, nene të cilat ndërthuren me kompetencat e KLGJ-së. Ky veprim është në shkelje të hapur dhe cenon direkt pavlefshmërinë e aktit. Kështu që, të gjitha emërimet që bëhen në Gjykatën e Lartë, janë të parashikuara në një procedurë të detajuar, duke filluar nga ata që s'kanë fituar statusin dhe se si e fitojnë statusin dhe se si shpallet procedura, se si kalojnë më pas lëvizjet paralele apo ngritjet në detyrë. Aktualisht, konstatohet në faqen e internetit të GJL ngritje në detyrë dhe lëvizje paralele. Ky nuk është rekrutim konform ligjit dhe prandaj është imediate të pezullohen procedurat.

Rimerr fjalën *zonja Shehu* e cila është dakord që t'i kërkohej informacion të gjitha gjykatave siç e kërkon zoti Muharremaj, por të pezullohen këto procedura dhe jo të vijojë të lejohet paligjshmëria. Nëse pas ardhjes së këtij informacioni, Këshilli do të bindet që procedurat janë bërë të ligjshme, atëherë le të mblidhet sërish Këshilli dhe të revokojë vendimin e pezullimit. Kjo duhet të jetë masa e parë paraprake që Këshilli duhet të marri, që të mos lejojë paligjshmërinë. Deri dje kur Këshilli nuk e dinte, ishte i justifikuar për mosreagim. Ndërsa sot Këshilli nuk është më i justifikuar pasi është detyrim ligjor kushtetues të reagojë.

Rimerr fjalën *zonja Luli* e cila shprehet se momenti që po diskutohet është momenti i ushtrimit të funksioneve kushtetuese që Këshilli i Lartë Gjyqësor ka në raport me gjykatat dhe të diskutohet sot që të mos ushtrohet një nga funksionet më të rëndësishme që parashikon ligji dhe Kushtetuta, është të hiqet dorë nga përgjegjësitë. Kështu që sipas gjykimit të zonjës Luli është shumë e rëndë situata nëse ky vendim do të ndahet me vota që të vendoset paligjshmëria, prandaj kërkon që të votohet unanimisht pezullimi dhe për t'i dhënë fund paligjshmërisë dhe heqjes dorë nga përgjegjësitë që Këshillit i takojnë.

Zoti Ilir Toska merr fjalën për të kërkuar një informacion rreth çfarë është bërë nga Këshilli me aktet nënligjore, me qëllim që situata të bëhet në përputhje me ligjin e ri që ka hyrë në fuqi prej disa vitesh?

Sa më sipër, **zonja Llagami** sqaron se në zbatim të e-mailit të disa anëtarëve, është kërkuar një informacion të gjithë gjykatave për procedurën e rekrutimit të zhvilluar nga ana e gjykatave dhe nga 38 gjykata, është kthyer përgjigje nga 17 prej tyre dhe pasi të vijnë të gjitha përgjigjet nga të gjitha gjykatat, do t'u përcillet informacioni i përmbledhur përmes një memoje të gjithë anëtarëve në lidhje me se si ka vepruar gjykata për shpërndarjen e 120 punonjësve.

Ndërsa sa i përket akteve nënligjore, pavarësisht se asnjë nga anëtarët e Këshillit nuk ka ngritur një shqetësim, në cilësinë e Kryetares së Këshillit, zonja Llagami ka ngritur një grup pune lidhur me hartimin e akteve nënligjore për nëpunësin civil gjyqësor. Grupi i punës ka filluar punën që në tetor për 14 akte nënligjore, duke hartuar jo vetëm aktet nënligjore për nëpunësin civil, akte të cilat janë të lidhura edhe me strukturat e gjykatave dhe në bazë të këtyre strukturave do hartohen përshkrimet e punës dhe në bazë të këtyre përshkrimeve të punës, në zbatim të nenit 38, është Këshilli i Gjykatave që rekruton dhe konfirmon nëpunësit gjyqësorë civilë. Zonja Llagami bën me dije se grupi i punës e ka finalizuar punën (edhe rregulloren e brendshme), punë e cila është përcjellë për mendim më 28 janar të dy partnerëve ndërkombëtarë që asistojnë Këshillin. Misioni EURALIUS ka kthyer mendimin e tij lidhur me këto akte, ndërsa me USAID është lënë ende në proces diskutimi për shkak edhe të volumit të akteve dhe për shkak të situatës së pandemisë. Gjithashtu, këto akte u janë përcjellë edhe gjykatave, për të marrë edhe një “feedback” nga gjykatat duke qenë se gjykatat do të jenë strukturat që do t'i zbatojnë këto akte. Lidhur me këto akte nënligjore, mund të kenë dhënë mendim deri tani vetëm 2-3 gjykata.

Zonja Llagami informon se aktet janë bërë nga administrata dhe mund të finalizohen brenda muajit, me përcjelljen gjithashtu më pas tek anëtarët e në përfundim përcaktimin e Komisionit që duhet t'i marrë në shqyrtim për t'i propozuar në Këshill këto akte.

Në përgjigje të pyetjes së **zonjës Kadi** mbi bazën ligjore që është përdorur në urdhrin për ngritjen e grupit të punës nga ana e Kryetares së Këshillit, për hartimin e këtyre akteve nënligjore, arsyen e mosinformimit të anëtarëve të Këshillit, si dhe përbërjen e këtij grupi pune, zonja Llagami sqaron se si titullare e institucionit ka të drejtë të ngre grupe pune dhe sa i përket akteve ato t'i përcillen të gjitha anëtarëve.

Zonja Kadi rimerr fjalën për të theksuar mbi të drejtën që ka Kryetarja e Këshillit për të ngritur grupe pune që draftojnë akte, akte të cilat i ka kompetencë Këshilli, prandaj ky urdhër pune, nuk mendon se ka një bazë ligjore, gjithsesi e ripyet edhe një herë zonjën Llagami mbi bazën ligjore që është përdorur në urdhër.

Zoti Toska rimerr fjalën për t'u shprehur mbi devijimin që po i bëhet çështjes, pasi pyetja që zoti Toska shtroi për diskutim ishte në lidhje me kohën e përgatitjes së akteve nënligjore dhe çfarë po ndodh me këto akte nënligjore, në mënyrë që të kalojnë në Komisionin përkatës dhe më pas të kalohen nga Këshilli. Se si punon administrata e Këshillit, është një çështje tjetër, -shton zoti Toska. E rëndësishme është që aktet nënligjore janë punuar nga administrata dhe s'ka nevojë të ketë një bazë ligjore për të punuar.

Rimerr fjalën **zonja Llagami** për të theksuar se aktet janë pothuajse një material i mbaruar. Me ardhjen e mendimeve nga të gjitha gjykatat dhe USAID, nga java në vazhdim aktet do të jenë të finalizuara pasi janë hartuar edhe relacionet përkatëse si dhe janë reflektuar edhe mendimet e Misionit EURALIUS.

Në përgjigje të pyetjes së **zonjës Shehu** e cila kërkoi të dijë kush ka punuar në grupin e punës për këto akte nënligjore, zonja Llagami thekson se në grupin e punës ka qenë departamenti i cili merret me burimet njerëzore në Këshill. Ndërkohë zonja Shehu shprehet se rezulton që të ketë një produkt që i është përcjellë Misioneve dhe gjykatave, ndërkohë që praktika e Këshillit është që materiali del nga Komisioni dhe i përcillet më pas Misioneve dhe gjykatave, pasi sipas zonjës Shehu nuk mund të përcillet, një material që përfaqëson vullnetin e Këshillit, nga një grup pune i pidentifikuar tek Misionet.

Në vijim të fjalës së zonjës Shehu, **zoti Toska** thekson se nuk është e shkruar gjëkundë që duhet të kalojë në Këshill njëherë parimisht dhe pastaj t'i shkojë Misioneve. Gjithashtu zoti Toska thekson që vullneti i Këshillit materializohet kur miratohet. E rëndësishme është që janë bërë e që Këshilli të ecë për ta miratuar dhe nuk ka rëndësi kush është ulur për ta shkruar.

Ndërkohë, zoti Toska pyet nëse materiali i bërë gati të mund të kalojë në Komisionin përkatës. Propozimi i zotit Toska është që të ecet me ato akte që janë, pasi nuk mund të pritët nga Këshilli pafundësisht opinionin e disa gjykatave që mund të mos e sjellin brenda javës.

Zonja Kadi thekson sërish faktin që grupi i punës, i ngritur pa asnjë bazë ligjore, ka punuar; i është dërguar edhe Misioneve ky produkt që anëtarët nuk kanë asnjë informacion që ekziston dhe ndërkohë do duhet që në gjysmë dite anëtarët të njihen mbi këtë produkt të një stafi administrativ të pidentifikuar që nuk dihet nëse kanë apo jo kompetencë, pasi duhet ta vendosë Këshilli këtë gjë.

Në përgjigje të sa më sipër **zonja Llagami** shprehet se në cilësinë e Kryetares dhe në cilësinë e personit përgjegjës për mirëfunksionim e Këshillit dhe zbatimin me efikasitet të detyrave, ka marrë përgjegjësinë për të ngritur një grup pune për të bërë një produkt e më pas të konsultohet me partnerët ndërkombëtarë e me gjykatat dhe më pas të futej në mbledhje plenare për t'u diskutuar mbi kompetencën. Është dërguar edhe e-mail mbi ndarjen e këtyre akteve dhe nuk është marrë asnjë përgjigje nga anëtarët.

Zonja Kadi përgjigjet që nuk mund të futet në kompetenca të një Komisioni që nuk i përket, gjithashtu sa i përket kompetencave të Kryetarit të KLGJ-së shprehet se Kryetari i KLGJ-së ka kompetenca mbi administratën e Këshillit, por jo mbi administrimin e gjykatave. Nuk mund të flitet në emër të Këshillit me vullnetin dhe iniciativën personale, -shton zonja Kadi.

Zonja Llagami përgjigjet që nuk ka asnjë kufizim që të çojë një akt për mendim dhe të bëjë edhe grupe pune.

Lidhur me këtë, **zonja Kadi** e pyet se me çfarë cilësie është dërguar ky akt për mendim.

(Midis zonjës Kadi dhe zonjës Llagami ka diskutime dhe audio vjen dhe ikën dhe nuk dëgjohet qartë.)

E në vijim, **zonja Llagami** vazhdon që këtu nuk diskutohet fakti që ka një produkt dhe nuk nisët nga zero, por këtu merren me si u bë ky produkti, si u caktua produkti, nëse kishin anëtarët dijeni kur u caktua produkti. Zonja Llagami shton që produkti nuk është final dhe komisionin kompetent do e vlerësojnë anëtarët sepse sot e kësaj dite akoma ka diskutime mbi kompetencat që ka secili komision për të hartuar aktet. Të paktën është bërë një lloj produkti nga zonja Llagami dhe do e propozonte duke ia dërguar të gjithë anëtarëve.

Zonja Kadi pyet se në çfarë cilësie është bërë kjo gjë?

Zonja Llagami përgjigjet që është bërë në cilësinë e Kryetarit dhe në cilësinë e një anëtari, ku dhe çdo anëtar, për shkak të shqetësimeve që mund të ketë, mund të bëhet një produkt dhe të propozohet në mbledhje plenare.

Gjithashtu zonja Llagami thekson që nuk ka asnjë pengesë që të konsultohet dhe gjithashtu edhe stafi të konsultohet me Komisionet.

Në lidhje me këtë **zonja Kadi** shprehet se si kryetare e Këshillit, zonja Llagami ka të drejta të tjera e privilegje të tjera si dhe shton se në emrin e saj nuk ka folur, as për gjënë më të pavlerë. Nuk mund të flitet në emër të Këshillit me vullnetin dhe iniciativën personale, -shton më tej zonja Kadi, duke ritheksuar edhe një herë që zonja Llagami nuk e ka këtë kompetencë që të flasë në emër të Këshillit pa e pyetur Këshillin.

(Midis zonjës Kadi dhe zonjës Llagami ka diskutime dhe audio vjen dhe ikën dhe nuk dëgjohet qartë.)

Zoti Toska ndërhyr për të ndërprerë diskutimet midis zonjës Kadi dhe zonjës Llagami, pasi debati është joproduktiv dhe ndërkohë drejton pyetjen nëse ka në proces sot në gjykata të tilla procedura.

Zoti Qoku i përgjigjet që aktualisht kanë procedura të tilla sepse në momentin që u mbyllën për efektin e pandemisë, i kishin shpallur dhe tani janë drejt përfundimit. Prandaj dhe u tha më sipër nga zoti Qoku që në mbledhjen e majit është diskutuar nga zonja Hajro në atë kohë dhe është konkluduar fakti që në mundësi të respektimit të kushteve të ligjit por në mungesë të akteve nënligjore nga KLGJ-ja, të operohet sipas sistemit të vjetër, por gjithmonë me Kod Pune dhe aty është theksuar që nuk flitej për nëpunës civil gjyqësor, por thjesht rekrutime deri në ardhjen e akteve. Gjykatat Korçë, civile dhe penale, Lezha, Kavaja, apeli Vlorë, janë në procedura rekrutimi.

Zoti Toska rimerr fjalën dhe thekson se nga e gjithë kjo situatë kuptohet që gjykatat kanë vepruar jo në bazë të ligjit në fuqi, por në bazë të legjislacionit të mëparshëm, kjo për shkak të pamundësisë së zbatimit të ligjit të ri, i cili ngarkon Këshillat e Gjykatave për të bërë disa procedura, ndërkohë ngarkon edhe KLGJ-në për të nxjerrë disa akte nënligjore. E gjithë kjo situatë ka ardhur për shkak të vonesave në konstituimin e KLGJ-së dhe më tej të Këshillave të Gjykatave dhe për shkak të mosushtrimit nga Këshilli të përgjegjësishë për të miratuar aktet nënligjore. Situata nuk është në përputhje me ligjin dhe Këshilli është përgjegjës për këtë situatë të krijuar. Meqenëse Këshilli ka në proces draftimin e akteve nënligjore, zoti Toska kërkon që Komisioni përgjegjës të përfundojë sa më parë draftimin e tyre dhe t'i përcillen Këshillit për miratim përfundimtar dhe ndërkohë, mundet që të konsiderohet një pezullim i përkohshëm i procedurave, me qëllim që të përputhen rekrutimet, lëvizjet në detyrë apo ngritjet në detyrë, në përputhje me ligjin në fuqi. Kjo do të thotë që Komisioni përgjegjës t'i sjellë sa më parë aktet nënligjore që Këshilli mos të bëhet pengesë për rekrutimet në gjykata, pasi Këshilli është përgjegjës për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, përgjegjës për ndjekjen e çështjeve të burimeve gjyqësore në gjykata.

Zoti Toska është pro projektvendimit, sa kohë konsideron që ka disa akte të draftuara dhe periudha e miratimit të tyre do të jetë shumë e shkurtër. Në një situatë të ndryshme do të ishte kundër thjesht për faktin që me përgjegjësinë e mosushtruar nga Këshilli do të cenonte funksionalitetin e gjykatave duke i linë të tilla për shumë kohë.

Hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i ardhur nga anëtarët e Këshillit “Për pezullimin e procedurave të lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë, emërimit të punonjësve të gjykatave, statusi i të cilëve rregullohet nga Ligji nr.98/2016 “Për organizmin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë””, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është kundër pezullimit, pasi nuk dihet sa të do të jetë kohëzgjatja e përpilimit të këtyre akteve, ku për hir të vërtetës, referuar Kreut 5, vetëm për statusin e nëpunësit civil gjyqësor në të gjithë nenet përkatës, kërkohen nga KLGJ që të bëhen 10 akte nënligjore, prandaj dhe voton kundër pasi mund të sjellë pasoja të pariparueshme në veprimtarinë e gjykatave.

Brunilda Kadi është dakord për pezullimin, pasi mospezullimi do të sillte pasoja të pariparueshme.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është kundër, me arsyetimin që ka bërë në fjalën e tij më lart.

Brikena Ukperaj është kundër.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është kundër.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi pezullimin e procedurave të lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë, emërimit të punonjësve të gjykatave, statusi i të cilëve rregullohet nga ligji nr. 98/2016 “Për organizmin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, deri në miratimin e akteve nënligjore përkatëse nga Këshilli.

Ky vendim t’i njoftohet të gjitha gjykatave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 28.05.2020)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e pjesëmarrjes së gjyqtarëve në trajnimin vazhdues pranë shkollës së magistraturës për periudhën prill – qershor 2020”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 16:55.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Ilir Toska*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Dritan Hallunaj**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e pjesëmarrjes së gjyqtarëve në trajnimin vazhdues pranë shkollës së magjistraturës për periudhën prill – qershor 2020”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Erjon Muharremaj.

Merr fjalën zoti Erjon Muharremaj i cili lexon relacionin shpjegues mbi projektvendimin “Për miratimin e pjesëmarrjes së gjyqtarëve në trajnimin vazhdues pranë shkollës së magjistraturës për periudhën prill – qershor 2020”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor është në bashkëpunim të vazhdueshëm me Shkollën e Magjistraturës, në kuadër të formimit fillestar dhe formimit vazhdues që kjo Shkollë organizon, me qëllim rritjen profesionale të gjyqtarëve.

Në vijim të programit vjetor të trajnimit, Shkolla e Magjistraturës ka dërguar pranë KLGJ listën e aktiviteteve trajnuese të programit të trajnimit vazhdues dhe atë të gjyqtarëve aplikues, për tremujorin e tretë të vitit akademik 2019-2020, me qëllim miratimin e pjesëmarrjes së gjyqtarëve aplikues. Rezulton se aktivitetet trajnuese prej datës 10 mars deri në 10 prill 2020 nuk janë zhvilluar për shkak të masave kufizuese gjatë kohës së pandemisë dhe aktivitetet trajnuese janë zhvilluar nëpërmjet platformave të komunikimit në distancë. Disa aktivitete gjithashtu nuk janë zhvilluar, për shkak të pamundësisë teknike të pjesëmarrësve për të realizuar komunikimin në distancë.

Aktivitetet të cilat nuk janë zhvilluar për shkaqet e mësipërme, planifikohet të zhvillohen në një periudhë të mëvonshme, brenda muajit qershor 2020.

Në referim të parashikimeve ligjore (neni 272/1 dhe 272/3 dhe nenit 88 /a/ dhe /c/ të ligjit nr.115/2016) lista e pjesëmarrjes në aktivitete trajnuese të magjistratëve, miratohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe i dërgohet Shkollës së Magjistraturës.

Referuar sa më lart, në pikën e parë të projektvendimit që i paraqitet sot për miratim Mbledhjes Plenare, është përcaktuar miratimi i listës së gjyqtarëve për të marrë pjesë në aktivitetet e përcaktuara, sipas kërkesave të përcjella prej tyre pranë Shkollës së Magjistraturës. Subjektet aplikues ushtrojnë detyrën e gjyqtarit ose gjyqtarit të komanduar në KLGJ, të cilët plotësojnë kushtet ligjore dhe kanë detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës, në referim të nenit 5 të Ligjit për Statusin.

Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale ka vlerësuar që në listën e miratuar, të mos përfshihen gjyqtarët që iu ka mbaruar statusi i magjistratit në referim të nenit 1 pika 2 dhe 64 pika 1 të Ligjit për Statusin. Në listën e gjyqtarëve aplikues të dërguar nga SHM, është konstatuar se një prej gjyqtarëve aplikues nuk e gëzon aktualisht statusin e magjistratit (z. Shkreli).

Gjithashtu, në kërkesën dhe listën bashkëlidhur, përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës, në aktivitetin trajnues të datës 22 maj 2020, përveç gjyqtarëve, janë përfshirë edhe kancelarët e gjykatave të cilët kanë aplikuar për të marrë pjesë në këtë aktivitet, pasi në referim të parashikimeve ligjore (neni 90/1/dh e ligjit nr. 115/2016, neni 52/1 dhe 52/2 e ligjit nr.98/2016) Këshilli bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës për realizimin e trajnimit fillestar dhe vazhdues të kancelarëve, por nuk parashikohet vendimmarrje e Këshillit mbi pjesëmarrjen e kancelarëve në trajnimin vazhdues, apo për miratimin e kërkesave të tyre për pjesëmarrje në aktivitetet trajnuese të përzgjedhura, sikurse parashikohet shprehimisht për gjyqtarët në nenin 272 pika 3 dhe 88 shkronja “c” të Ligjit nr.115/2016.

Për këto arsye, Komisioni ka vlerësuar që në listën e aktivitetit trajnues të datës 22 maj 2020 të listohen vetëm gjyqtarët aplikues dhe jo kancelarët e gjykatave, sipas listës së përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës.

Në pikën e dytë të projektvendimit është përcaktuar detyrimi i magistratëve për të marrë pjesë në sesionet e aktivitetit trajnues sipas rregullave të përcaktuara nga organizatori i aktivitetit, me qëllim sigurimin e pjesëmarrjes së tyre, zhvillimin e rregullt të aktivitetit trajnues si dhe certifikimin e pjesëmarrësit, si një ndër elementët e vlerësimit profesional të tij.

Në pikën e tretë të projektvendimit është përcaktuar detyrimi i magistratit për të organizuar paraprakisht punën lidhur me planifikimin e seancave dhe veprimeve që kanë lidhje me gjykimin e çështjeve, me qëllim mos shtyrjen e seancave gjyqësore për shkak të pjesëmarrjes në aktivitete trajnuese.

Në pikën e katërt të projektvendimit është përcaktuar detyrimi i njoftimit të vendimit Shkollës së Magjistraturës dhe gjykatave/institucioneve ku gjyqtarët pjesëmarrës ushtrojnë detyrën e gjyqtarit apo detyra të tjera si gjyqtarë të komanduar.

Referuar listës së pjesëmarrësve dhe periudhës 3-mujore, është propozuar miratimi i një pjesëmarrjeje brenda kufijve të detyrimit ligjor jo më pak se 5 dhe jo më shumë se 40 ditë në vit.

Lidhur me mënyrën e trajtimit financiar të magistratit lidhur me shpenzimet e nevojshme të udhëtimit dhe akomodimit për shkak të angazhimit në aktivitetet e trajnimit vazhdues, në nenin 5, pika 5, të Ligjit nr. 96/2016 parashikohet se shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit të magistratëve në ndjekje të programit të formimit vazhdues mbulohen nga fondi i miratuar për këtë qëllim në Shkollën e Magjistraturës ose fonde nga burime të tjera të përcaktuara për këtë veprimtari.

Referuar Komisionit, ky vendim për miratimin e pjesëmarrjes së gjyqtarëve në trajnimin vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës, në thelb nënkupton pajisjen e gjyqtarëve me leje për ndjekjen e këtyre trajnimeve, sipas pikës 6, të nenit 5, të Ligjit 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Pavarësisht se çështjet që lidhen me trajnimin vazhdues të gjyqtarëve nuk janë kompetencë e Mbledhjes Plenare, për sa kohë nuk ka ende një vendimmarrje të KLGJ-së në lidhje me procedurën e pajisjes me leje për ndjekjen e trajnimeve vazhduese (akt nënligjor normativ) dhe as është miratuar një rregullore e brendshme e Këshillit për çështjet për të cilat çdo Komision i Përhershëm ka kompetenca vendimmarrëse,

Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale vlerëson se kjo çështje duhet të shqyrtohet në Mbledhje Plenare.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë diskutime, pyetje apo sugjerime për çështjen në fjalë, ndaj hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit projektvendimi “Për miratimin e pjesëmarrjes së gjyqtarëve në trajnimin vazhdues pranë shkollës së magistraturës për periudhën prill – qershor 2020”, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi: 1. Të miratojë kërkesat e gjyqtarëve për të marrë pjesë në programin e formimit vazhdues pranë Shkollës së Magistraturës, për periudhën prill 2020 – qershor 2020, sipas listës së pjesëmarrësve për çdo aktivitet trajnimi bashkëlidhur këtij vendimi, pjesë përbërëse e tij.

2. Gjyqtarët e miratuar sipas pikës 1 të këtij vendimi, marrin pjesë në aktivitetet trajnuese, sipas rregullave të parashikuara në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magistraturës.

3. Gjyqtarët duhet të marrin masa organizative për të mos penguar ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore ose asaj për të cilën janë komanduar, në ditën që do të marrin pjesë në aktivitetin trajnues.

4. Ky vendim i njoftohet Shkollës së Magistraturës, gjykatave dhe institucioneve të tjera ku gjyqtarët, sipas listës së miratuar bashkëlidhur këtij vendimi, ushtrojnë detyra të tjera si gjyqtarë të komanduar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 28.05.2020)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e detajimit të fondeve shtesë në shpenzime personeli, në programin buxheti i gjykatave”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 16:55.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Ilir Toska* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
9. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, *zoti Dritan Hallunaj*.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 5. Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.**
- 6. Xhevdet Haxhiu, Drejtor pranë Drejtorisë së Programimit dhe Monitorimit të Buxhetit.**

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e detajimit të fondeve shtesë në shpenzime personeli, në programin buxheti i gjykatave”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit.

Lidhur me detajimin e këtij projekt-akti, relaton zonja Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit pranë KLGJ-së.

Në fjalën e saj zonja Laze shprehet se me vendimin nr. 323, datë 27.12.2019 KLGJ ka detajuar fondet për shpenzimet korente për të gjithë sistemin gjyqësor. Referuar faktit që ka mungesa të mëdha të numrit të gjyqtarëve në fakt, krahasuar me numrin sipas strukturave organike, për një administrim sa më të mirë të fondeve, detajimi i buxhetit në shpenzime personeli është kryer sipas numrit faktik.

Ka kaluar një periudhë 5-mujore, ku akti normativ nr.15 i qeverisë ka bërë një pjesë të shkurtimit të fondeve në shpenzime të personelit dhe nga ana tjetër, me vendimin nr. 115, 05.03.2020 KLGJ ka detajuar numrin e punonjësve shtesë dhe në këtë kuptim është e nevojshme që të jepen fondet shtesë që gjykatat kanë, pasi janë analizuar për

nevojat që ata kanë deri në fund të vitit dhe është vlerësuar që fondi prej 73,820,000 lekë është i nevojshëm që t'iu shpërndahet gjykatave (i ndarë në 61,470,000 lekë për shpenzime të pagave dhe 12,350,000 lekë për shpenzime të sigurimeve shoqërore).

Gjithashtu, është përfshirë në këtë nevojë edhe ajo që ka evidentuar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, në shpenzimet e personelit, në zbatim të vendimit të KLGJ-së nr. 16/2020 “Për revokim të vendimit nr. 47, të ish-KLD-së “Mbi pezullimin e detyrave të gjyqtarit... Osman Aliu” dhe të vendimit tjetër të KLGJ-së nr. 17, 09.01.2020 “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin Osman Aliu”.

Gjithashtu mbetet një fond tjetër i pashpërndarë prej 121 milion lekë, fond i cili është i mjaftueshëm për 19 magjistratët e rinj dhe mendohet që ky të shpërndahet në momentin kur të emërohen nga KLGJ-ja. Gjithashtu ky fond i pashpërndarë, mund të shërbejë edhe për nevoja të tjera që mund të lindin gjatë vitit.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë diskutime, pyetje apo sugjerime për çështjen, prandaj hidhet në votim miratimi i projektvendimit “Për miratimin e detajimit të fondeve shtesë në shpenzime personeli, në programin buxheti i gjykatave”, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: 1. Miratimin e detajimit të fondeve shtesë sipas nevojave të gjykatave, në shpenzimet personeli në shumën prej 73,820,000 lekë, nga të cilat, shpenzime paga (600), në shumën 61,470,000 lekë dhe

shpenzime sigurime shoqërore (601), në shumën 12,350,000 lekë, sipas pasqyrës bashkëlidhur.

2. Fondet e mbetura të pa detajuara, në shpenzime personeli (600-601), në shumën prej 121,930,000 lekë, të mbeten të tilla, deri në momentin e shfaqjes së nevojave nga emërimet të reja në sistemin gjyqësor.

3. Me zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 28.05.2020)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin e disa automjeteve nga Gjykata e Lartë, pranë gjykatave të tjera dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 16:55.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Ilir Toska | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 9. Erjon Muharremaj | (anëtar) |
| 10. Marçela Shehu | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Dritan Hallunaj**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 5. Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.**
- 6. Xhevdet Haxhiu, Drejtor pranë Drejtorisë së Programimit dhe Monitorimit të Buxhetit.**

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin e disa automjeteve nga Gjykata e Lartë, pranë gjykatave të tjera dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit.

Për relatimin e projektvendimit “Për transferimin e disa automjeteve nga Gjykata e Lartë, pranë gjykatave të tjera dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor”, ftohet zoti Xhevdet Haxhiu, Drejtor pranë Drejtorisë së Programimit dhe Monitorimit të Buxhetit.

Ndër të tjera, zoti Haxhiu shprehet se në vijim të shkresës së Gjykatës së Lartë ku sjellin si propozim të transferohen në disa gjykata disa nga automjetet e tyre. Ky propozim vjen si rezultat i situatës së krijuar për shkak të mungesës për një kohë të gjatë të gjyqtarëve të kësaj gjykate, automjetet e të cilëve qëndrojnë të parkuar në ambientet pranë gjykatës duke mos sjellë shfrytëzimin e tyre.

Në vlerësim të kësaj kërkese, pasi u analizuan nevojat e evidentuara nga disa gjykata, u konkludua që të transferohen 3 automjete, një në Gjykatën e Apelit Vlorë, një në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe një në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.

Gjithashtu për nevojat e Këshillit janë kërkuar edhe dy automjete (një në funksion të Kryetarit të Këshillit dhe një në funksion të Zëvendëskryetarit të Këshillit).

Ndaj sa më sipër, në zbatim të VKM-së nr. 153, datë 03.4.1993 “Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, të Ministrisë së Financave, sugjerohet transferimi i 3 automjeteve, pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, si dhe të 2 automjeteve në institucionin e KLGJ-së.

Diskutime/Komente/Pyetje/Propozime mbi çështjen

Merr fjalën *zonja Kadi* e cila drejton disa pyetje zotit Haxhiu:

-A ka fonde të tjera në makina Gjykata e Lartë për tre gjyqtarët që janë emëruar atje?

-Sa makina ngelen konkretisht?

-A janë në gjendje pune makinat që janë në gjykatë?

Ndërkohë, zonja Kadi sugjeron që në relacion të korrigjohet termi “drejtuesit kryesorë”, pasi Këshilli ka vetëm një drejtues.

Gjykata e Lartë ka mjaftueshëm makina për gjyqtarët dhe për administratën; Në lidhje me pyetjen e dytë, zoti Haxhiu përgjigjet se kanë qenë 17 me gjithë gjyqtarët, por përderisa propozimi vjen nga vetë gjykata, ata e kanë përlllogaritur. Ndërsa sa i përket pyetjes së tretë, makinat janë në gjendje pune, -përgjigjet zoti Haxhiu.

Lidhur me sugjerimin e zonjës Kadi për të korrigjuar termin e përdorur në relacion “drejtuesit kryesorë”, ai do të merret parasysh dhe do të korrigjohet.

Ndërsa lidhur me pyetjen drejtuar nga *zoti Toska* i cili ishte keqkuptuar duke menduar që të tre këto makina do të transferoheshin në Gjykatën e Apelit Vlorë, zoti Haxhiu rithekson që makinat janë për tre gjykata, pra një makinë për gjykatë. Ndërsa dy makinat e tjera janë për Këshillin.

Gjithashtu edhe **zoti Alban Toro** i drejton pyetje zotit Haxhiu lidhur me gjendjen e automjeteve për gjyqtarët e rinj që do të emërohen në Gjykatën e Lartë apo do t'i duhet Këshillit të bëjë ndonjë tender në një moment të dytë për riparimin e tyre? Pyetja vijuese e zotit Toro është sa i përket vit prodhimit të automjeteve që disponon Gjykata e Lartë.

Zoti Haxhiu rithekson që Gjykata e Lartë e lartë disponon mjaftueshëm mjete transporti për nevojat e gjyqtarëve në detyrë dhe për ato që priten të emërohen. Lidhur me pyetjen e zotit Toro, shprehet se të gjitha makinat janë teknikisht të afta, bashkë edhe më këto makinat që po i kalojnë Këshillit të cilat janë analizuar dhe evidentuar nga vetë Gjykata e Lartë.

Në lidhje me pyetjen tjetër të zotit Toro, sa i përket vitit të prodhimit të makinave, makinat kanë vit prodhimi më të re se makinat që kërkohet të transferohen, të cilat janë të vit prodhimit 2005.

Rimerr fjalën **zonja Kadi** për të drejtuar një tjetër pyetje zotit Haxhiu lidhur me numrin e makinave të reja që janë miratuar nga ana e Këshillit, që kanë qenë 14 makina dhe pse duhet të transferohen edhe 2 makina nga Gjykata e Lartë, ndërkohë që atje shumë shpejt do të plotësohet trupa gjyqësore e cila do të ketë nevojë për makinat.

Në përgjigje të pyetjes së zonjës Kadi, **zoti Haxhiu** shprehet se Këshilli ka mbajtur 12 makina të reja me kilometrazh zero dhe 2 janë këto makina të cilat ishin me akt përdorimi dhe të cilat po kërkohet që kalojnë në pronësi për efekt të kryerjes së shpenzimeve nga ana e KLGJ-së, të cilat kanë qenë të panevojshme që në krye të herës nga Gjykata e Lartë.

Pyetjes tjetër të zonjës Kadi se sa makina ka Këshilli sot pa këto 2 makina, -zoti Haxhiu i përgjigjet se Këshilli ka në pronësi 12 makina. Ndërsa në përdorim kanë këto 2 makina të cilat po kërkohet të kalojnë në pronësi për efekt të kryerjes së shpenzimeve.

Në vijim, **zonja Kadi** propozon që këto makina t'i qëndrojnë Gjykatës së Lartë, duke qenë se janë makina relativisht më të mirëmbajtura se ato të tjera dhe duhet të jenë

për gjyqtarët që presin dita-ditës që t'i shtohen gjykatës, ose t'i kalojnë 2 makina të reja Gjykatës së Lartë.

Zoti Bici merr fjalën për të sqaruar sa i përket vitit të prodhimit të makinave në Gjykatën e Lartë, duke theksuar se 7 makina janë të vitit 2005, ndërsa të tjerat janë vit prodhimi më të reja.

Pas diskutimeve/pyetjeve, hidhet në votim fillimisht nga Kryetarja e Këshillit propozimi i bërë nga zonja Kadi për mostransferimin e këtyre 2 automjeteve të Gjykatës së Lartë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është kundër.

Brunilda Kadi është dakord.

Ilir Toska është kundër.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është kundër.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është kundër.

Brikena Ukperaj është kundër.

Medi Bici është kundër.

Naureda Llagami është kundër.

Hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit projekt-akti sipas propozimit të bërë nga Komisioni përkatës, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord pjesërisht, kundër për pjesën e votuar më lart për dy makinat.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord pjesërisht.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord pjesërisht.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi: 1. Miratimin e transferimit të 3 (tre) automjeteve nga Gjykata e Lartë, pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, sipas pasqyrës nr.1, bashkëlidhur.

2. Miratimin e transferimit të 2 (dy) automjeteve nga Gjykata e Lartë, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas pasqyrës nr.2, bashkëlidhur.

3. Me zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 28.05.2020)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve Kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankesës dhe Mbylljen e Hetimit ndaj Gjyqtarit”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 16:55.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Ilir Toska | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 9. Erjon Muharremaj | (anëtar) |
| 10. Marçela Shehu | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, *zoti Dritan Hallunaj*.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve Kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankesës dhe Mbylljen e Hetimit ndaj Gjyqtarit”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit.

Relatore e kësaj çështjeje është zonja Naureda Llagami.

Në fjalën e saj zonjë Llagami informon se pranë KLGJ-së kanë ardhur 4 kërkesa nga palë të cilët janë kundër vendimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për sa i përket mosfillimit të procedimit disiplinor. Për këtë arsye, në zbatim të nenit 62/13 është detyrimi i Këshillit që të krijojë një Komision të Përkohshëm, i cili do marrë në shqyrtim ankimet kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin ose pushimin e hetimit ndaj gjyqtarit. Komisioni duhet të jetë i përbërë nga 3 anëtarë (2 anëtarë jogjyqtarë dhe 1 anëtar gjyqtar) dhe 2 anëtarë zëvendësues të cilët do të zgjidhen nëpërmjet shortit dhe sugjerohet që brenda muajit janar të çdo viti përbërja e këtij Komisioni të ripërtërihet. Kryetari i Komisionit caktohet nga Kryetari i Këshillit.

Shqyrtimi i ankimeve nga komisioni i përkohshëm do të bëhet sipas radhës duke marrë parasysh datën e regjistrimit të tyre në regjistrin e protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Komisioni i përkohshëm dokumenton çdo veprim për shqyrtimin e ankimeve me procesverbal dhe për këtë shkak do të asistohet nga nëpunës të administratës të

caktuar nga Kryetari i Këshillit. Vendimet e komisionit të përkohshëm janë përfundimtare dhe duhet t'i njoftohen ankuesit, magjistratit, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky komision do të hartojë rregulla lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së tij, të cilat do të miratohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në një mbledhje plenare të tij.

Diskutime/Komente/Pyetje/Propozime mbi çështjen

Zonja Kadi merr fjalën për të informuar se grupi i punës për draftimin e rregullave të brendshme dhe tek ndarja e kompetencave është diskutuar që anëtarë të Komisionit të Përhershëm të Disiplinës nuk duhet të përfshihen në këtë Komision të Përkohshëm, në hipotezën që ndonjë nga këto vendime kthehet për hetim dhe vjen më pas në Këshill për t'u shqyrtuar nga ky Komision, aty do të jetë në kushtet e shprehjes së mendimit, ndaj e hedh si diskutim në parim nëse duhet të jenë pjesë e këtij Komisioni anëtarët e Komisionit të Disiplinës. Gjithashtu zonja Kadi hedh për diskutim edhe faktin që një Komision i tillë ngrihet për çdo rast konkret, me arsyetimin se një Komision i Përkohshëm ngrihet për një çështje të caktuar, pra zonja Kadi e mendon si një trup gjykues këtë Komision të Përkohshëm i cili në çdo rast konkret duhet të krijohet për të vendosur për rastin konkret.

Merr fjalën **zonja Ukperaj** në vijim e cila lidhur me diskutimin e parë që ngre zonja Kadi, vlerëson se pavarësisht ndalimit që parashikon ligji, nuk është problem, pasi kjo gjë do të shikohet nëse një çështje e caktuar shkon në Komisionin e Disiplinës. Nëse çështja shkon në Komisionin e Disiplinës, Komisioni ka edhe dy anëtarë zëvendësues. Nëse ndonjë nga anëtarët e Komisionit të Disiplinës ka qenë edhe anëtar i Komisionit të Përkohshëm, atëherë bëhet zëvendësimi. Pra, zonja Ukperaj nuk mendon që papajtueshmëria të shikohet aktualisht, pasi jo vetëm që lind çështje pas çështjeje, por ekziston mekanizmi zhblokues në momentin kur çështja shkon për procedim disiplinor. Ndaj vlerëson se nuk duhet të përjashtohen nga shorti anëtarët e Komisionit të Disiplinës.

Ndërsa, lidhur me diskutimin e dytë që të ngrihet Komision për çdo ankim, në fakt ligji thotë “për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve..”, zonja Ukperaj vlerëson se çështja është një dhe nuk ka disa çështje, pra çështja është të shqyrtohen ankimet ndaj

vendimeve të arkivimit dhe në vlerësimin e saj do të ishte më operative që të ngrihet një komision që të funksionojë mbi bazën 1-vjeçare.

Pyetjes së zonjës Kadi në lidhje me ku bazohet koncepti i afatit, **zonja Ukperaj** shprehet se për sa kohë Komisioni i Përkohshëm është për çështje të caktuara, nuk mund të jetë Komisioni i Përhershëm me afat 2 vjet e gjysmë dhe nisur nga kjo, mund të bëhet çdo janar, ose Komisioni të ngrihet edhe për 6 muaj dhe mund të vendosen edhe rregulla si për shembull të njëjtët anëtarë të mos vendosen tek komisioni tjetër.

Zonja Kadi rithekson edhe një herë mendimin e saj i cili është i njëjtë edhe me atë të EURALIUS, pra që për çdo rast të ngrihet komisioni pasi ky është koncepti i Komisionit të Përkohshëm. Problemi tjetër është ndarja e ngarkesës, të cilën zonja Kadi mendon që duhet të jetë një ndarje e drejtë dhe proporcionale dhe jo tre anëtarë të merren të gjithë vitin.

Merr fjalën **zoti Toska** i cili mendon që përkohshmëria nuk ka të bëjë me një çështje apo me dy çështje. Çështjet janë të të njëjtës natyrë dhe përkohshmëria është me kohën që ushtron mandatin komisioni që do të shqyrtojë ankesat që bëhen ndaj vendimit të ILD-së. Do të jetë më operative nëse do të ketë një Komision gati sa herë që të vijë ndonjë ankesë.

Nga ana praktike, ajo është e zgjidhshme, -shprehet **zonja Kadi**, pasi sot që është procedura e hedhjes së shortit, ku kanë ardhur 10 ankesa dhe në të njëjtën kohë të bëhen 10 trupa gjyqes. Ndërkohë rithekson edhe një herë konceptin e Komisionit të Përkohshëm i cili është për një çështje të caktuar.

Në lidhje me konceptin e Komisionit të Përkohshëm, **zoti Toska** shprehet se ai komision ka të bëjë me një çështje e cila varet nga natyra dhe jo nga sasia e rasteve apo problematikave që ka brenda dhe problematika është një në këtë rast, ankim ndaj vendimit për raste të caktuara.

Hidhet në votim propozimi i zonjës Kadi që Komisioni i Përkohshëm të ngrihet për çdo vendim të arkivuar, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është kundër.

Brunilda Kadi është dakord.

Illir Toska është kundër.

Alban Toro është kundër.

Fatmira Luli është kundër.

Marçela Shehu është kundër.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është kundër.

Medi Bici është kundër.

Naureda Llagami është kundër.

(2 anëtarë pro dhe 8 anëtarë kundër propozimit të zonjës Kadi.)

Hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit projekt-akti i propozuar nga Komisioni “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve Kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankesës dhe Mbylljen e Hetimit ndaj Gjyqtarit”, për të vijuar më pas me shortin, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi: Ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve Kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Më tej, vijohet me hedhjen e shortit për sa i përket përbërjes së Komisionit të Përkohshëm, që siç u tha më lart, do përbëhet nga 2 anëtarë jogjyqtarë dhe 1 anëtar gjyqtar.

Fillimisht hidhen në enën e qelqit 4 shiritat e letrës me emrat e 4 anëtarëve jogjyqtarë për të vijuar me tërheqjen e 3 prej tyre (ku emri i tretë do të jetë anëtari zëvendësues) dhe më tej hidhen në enën e qelqit 6 shiritat e letrës me emrat e 6 anëtarëve gjyqtarë, për të vijuar me tërheqjen e 2 prej tyre (ku emri i dytë do të jetë anëtari zëvendësues).

Pas hedhjes së shortit rezultoi se 2 anëtarët jogjyqtarë të përzgjedhur nga shorti janë: anëtari i parë i përzgjedhur nga jogjyqtarët z. Alban Toro, anëtari i dytë i përzgjedhur nga jogjyqtarët z. Erjon Muharremaj, anëtari i tretë zëvendësues i përzgjedhur nga jogjyqtarët është znj. Fatmira Luli; anëtari i parë i përzgjedhur nga gjyqtarët z. Ilir Toska, anëtari i dytë zëvendësues i përzgjedhur nga gjyqtarët znj. Brikena Ukperaj.

Pra përbërja e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve Kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari është: z. Alban Toro (anëtar jogjyqtar); z. Erjon Muharremaj (anëtar jogjyqtar), z. Ilir Toska (anëtar gjyqtar) dhe znj. Fatmira Luli (anëtare zëvendësuese jogjyqtare), znj. Brikena Ukperaj (anëtare zëvendësuese gjyqtare).

Hidhet në votim përbërja e Komisionit të Përkohshëm dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi: Ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve Kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari, i përbërë nga 2 anëtarë jo gjyqtarë dhe 1 anëtar gjyqtar dhe konkretisht: z. Alban Toro, z. Erjon Muharremaj dhe z. Ilir Toska (anëtarë zëvendësues znj. Fatmira Luli dhe znj. Brikena Ukperaj).

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 28.05.2020)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 62, datë 30.01.2020, “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë”, i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm i ngritur me vendimin nr.62, datë 30.01.2020.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 16:55.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Ilir Toska** (anëtar)
- 7. Alban Toro** (anëtar)
- 8. Brikena Ukperaj** (anëtar)

9. Erjon Muharremaj (anëtar)

10. Marçela Shehu (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti **Dritan Hallunaj**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.

4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 62, datë 30.01.2020, “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë””, i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm i ngritur me vendimin nr.62, datë 30.01.2020.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Maksim Qoku.

Merr fjalën zoti Maksim Qoku i cili lexon relacionin shpjegues mbi projektvendimin “Për një ndryshim në vendimin nr. 62, datë 30.01.2020, “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë”.

Ndër të tjera, zoti Qoku parashtron se Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kriterëve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë që do të pranohen në provimin e pranimit për programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, në respektim të procedurës së përcaktuar

në ligj, ka marrë përsipër të japë komentet ose kundërshtimet për kandidatët për magistratë, profili gjyqtar, që do të pranohen në provimin e Pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020 – 2021, bazuar në dokumentet e paraqitura nga çdo kandidat.

Shkolla e Magjistraturës ka përcjellë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor listën përfundimtare me 293 konkurreues që kanë aplikuar për t'u pranuar në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për magistrat, në profilin gjyqtar (2020-2021)

Referuar nenit 30/4 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku parashikohet se “...Këshillat mund të japin komente ose kundërshtime...”, vlerësohet e arsyeshme që ky komision të përgatisë gjithashtu dhe të japë komente ose kundërshtime për kandidatët për magistratë, profili gjyqtar, që do të pranohen në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020 – 2021. Ndaj, propozohet që të bëhet një shtesë në vendimin nr. 62, datë 30.01.2020, të KLGJ-së dhe konkretisht:

Në pikën 1, pas fjalëve “ndihmës ligjorë” të shtohen fjalët “... si dhe të japë komente ose kundërshtime për kandidatët për magistratë, profili gjyqtar, që do të pranohen në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020 – 2021”.

Në pikën 4, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Komisioni i Përkohshëm përpilon komentet ose kundërshtimet për kandidatët për magistratë, profili gjyqtar, që do të pranohen në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020 - 2021, duke i propozuar për miratim Këshillit të Lartë Gjyqësor, opinionin mbi listën përkatëse të kandidatëve që plotësojnë kriteret, si dhe listën e atyre që nuk plotësojnë kriteret ”.

Ndërkohë propozohet që edhe në pikën 5 pas fjalëve “ndihmës ligjorë” shtohen fjalët “... si dhe të japë komente ose kundërshtime për kandidatët për magistratë, profili Gjyqtar, ...”.

Zonja Llagami informon që me vendim të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës është përcaktuar data 26 dhe 29 qershor dhe zhvillimin e provimit, dhe

sugjeron që komentet dhe sugjerimet nga ana e Komisionit të Përkohshëm të kalojnë sa më shpejt në Mbledhjen Plenare.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë diskutime, pyetje apo sugjerime për çështjen në fjalë, ndaj hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin nr. 62, datë 30.01.2020, “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë””, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor, miratoi projektvendimin sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë.

Anëtarët e Këshillit bëjnë një pauzë prej 30 minutash për t’u rikthyer sërish online për zhvillimin e 2 pikave të mbetura në rendin e ditës.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 28.05.2020)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, si më poshtë:

1. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Apelit”;
2. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Apelit”;
3. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”;
4. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”;
5. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”;
6. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”;
7. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”;
8. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”;
9. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”;

10. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”;
11. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”;
12. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”;
13. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”;
14. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”;
15. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”;
16. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”;
17. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 16:55.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Illir Toska*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

9. Erjon Muharremaj (anëtar)

10. Marçela Shehu (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti **Dritan Hallunaj**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Helena Papa, Drejtoresh pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.

4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, si më poshtë:

1. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Apelit”;
2. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Apelit”;
3. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”;
4. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”;
5. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”;
6. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”;
7. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”;

8. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”;
9. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”;
10. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”;
11. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”;
12. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”;
13. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”;
14. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”;
15. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”;
16. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”;
17. “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Merr fjalën zoti Ilir Toska i cili lexon relacionin shpjegues mbi 16 projektvendimet për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë gjykatave të apelit në fushën e së drejtës administrative, civile dhe penale.

Ndër të tjera, zoti Toska parashtron fillimisht disa nga përgjegjësitë që ka Këshilli i Lartë Gjyqësor në lidhje me zhvillimin e karrierës gjyqësore, përgjegjësi të cilat gjejnë rregullim në: neni 147/a, pika 1, germa “a”, i Kushtetutës parashikon se: “1. Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme: a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve...”; në nenin 86, shkronja “c” dhe “ç” të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së drejtësisë”, i ndryshuar; në nenin 43 të Ligjit për

Statusin (Procedura e lëvizjes paralele); në nenin 48 të Ligjit për Statusin (Ngritja në detyrë).

Sa i përket ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka hapur procedurat për ngritjen në detyrë pranë Gjykatës së Lartë, pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si dhe pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ndërsa sa i përket procedurave të lëvizjes paralele, kuadri ligjor nuk është plotësuar tërësisht, ndaj pritet të përfundojë dhe të kalojë për miratim në mbledhje plenare të Këshillit.

Ligji, për një periudhë kalimtare, pikërisht neni 25 i Ligjit nr. 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, caktimin në detyrë të gjyqtarëve të emëruar rishtazi nuk e ka ndërvarur nga përfundimi i procedurave të transferimit/lëvizjes paralele dhe/ose të ngritjes në detyrë të magjistratëve.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar aktet nënligjore në lidhje me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve, si dhe ka filluar realizimin e procedurave të vlerësimit sipas Ligjit për Statusin, por ende nuk ka bërë vlerësimet etike dhe profesionale të gjyqtarëve sipas këtij ligji. Po ashtu, afati i caktuar për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të magjistratëve ende nuk ka mbaruar.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, nëpërmjet projektvendimeve të propozuara, vlerëson se Këshilli përmbush edhe një nga kërkesat e ligjit në lidhje me procedurat që duhet të organizojë përpara caktimit në pozicion të magjistratëve të emëruar rishtazi. Gjithashtu, në lidhje me projektvendimet e paraqitura, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka mbajtur në konsideratë edhe faktin se Këshilli është në fazën e fundit të përgatitjes së propozimit për hartën e re gjyqësore dhe referuar informacionit të grupit të punës, është e qartë që do të ketë reduktim të gjykatave të apelit dhe riorganizimin e mundshëm të tyre në vetëm një gjykatë ose maksimumi në dy të tilla. Nisur nga kjo, është e qartë se miratimi i hartës së re gjyqësore do të sjellë transferimin e gjyqtarëve aktualë në gjykatën/gjykatat që do të mbesin pas riorganizimit gjyqësor, çka në aspektin praktik do të bëjë që realizimi përpara këtij procesi të procedurave të lëvizjes paralele të gjyqtarëve

të gjykatave të apelit nuk do të sjellë ndonjë impakt në mbarëvajtjen e përgjithshme të pushtetit gjyqësor, në veçanti të gjykatave të apelit.

Aktualisht gjykatat e apelit janë në nevojë urgjente për gjyqtarë, pasi numri i tyre në detyrë është reduktuar ndjeshëm si rrjedhojë e efekteve të shkaktuara nga procesi i rivlerësimit kalimtar. Aktualisht, numri i gjyqtarëve në gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm është 63, nga të cilët në detyrë janë vetëm 43 dhe 12 në gjykatën administrative.

Për shkak të nevojave të lindura nga mungesa e gjyqtarëve në gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, Këshilli i Lartë Gjyqësor, për vitin 2019, Këshilli ka trajtuar rreth 380 kërkesa të gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm, duke caktuar për çështje gjyqësore të veçanta rreth 650 gjyqtarë gjithsej, ndërkohë për dy muajt e parë të vitit 2020, Këshilli ka trajtuar 119 kërkesa të këtyre gjykatave duke caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta 189 gjyqtarë.

Rezulton se, aktualisht, në gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm ka 15 pozicione të lira që mund të plotësohen nëpërmjet ngritjes në detyrë të gjyqtarëve.

Për Gjykatën Administrative të Apelit, sa i përket procedurave të lëvizjes paralele, aktualisht këto procedura janë praktikisht të pamundura të realizohen ligjërisht, kjo për shkak se pika 9, e nenit 42, të Ligjit për Statusin, përcakton se: *“Në rast të hapjes së pozicioneve të lira në gjykatën e apelit administrativ, procedura e lëvizjeve paralele do të jetë e hapur vetëm për gjyqtarë që kanë punuar për të paktën për pesë vjet në 9 vitet e fundit si gjyqtar në çështjet administrative”*, dhe aktualisht, në gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm nuk ka asnjë gjyqtar që të plotësojë kërkesat e ligjit, pra që në nëntë vitet e fundit, të ketë punuar për të paktën për pesë vjet si gjyqtar në çështjet administrative.

Rezulton se, aktualisht, në Gjykatën Administrative të Apelit ka 1 pozicion të lirë dhe 1 pozicion tjetër që pritet të bëhet i lirë pas datës 30.06.2020, pra në total 2 pozicione, të cilët mund të plotësohen nëpërmjet ngritjes në detyrë të gjyqtarëve.

Nisur nga sa më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në ushtrim të përgjegjësisë për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor (neni 147, pika 1, i Kushtetutës) dhe në veçanti të funksionit të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të gjitha niveleve (neni

147/a, pika 1, shkronja “a”, i Kushtetutës), bazuar në nenin 48, pika 2, të Ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, ka obligimin të organizojë procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për çdo pozicion të lirë. Sipas dispozitës përkatëse, hapja e procedurës së ngritjes në detyrë organizohet me bërjen e lirë të pozicionit apo me konstatimin e pritjes për t’u bërë i lirë të tij në 3 muajt në vijim. Ndërkohë që, referuar përcaktimit të pikës 1, të nenit 39, të Ligjit të Statusit, indirekt parashikohet organizimi nga Këshilli të procedurave për ngritjen përpara muajit qershor të çdo viti.

Nga ana tjetër, sa i përket pozicioneve të lira në gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm, për të cilat Komisioni vlerëson se Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të organizojë një procedurë ngritje në detyrë, pavarësisht se numri aktual i pozicioneve të lira është 15, Këshilli duhet të organizojë procedurat për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve për 14 pozicione të lira.

Komisioni gjithashtu ka në konsideratë edhe caktimin përkohësisht të një gjyqtari në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për të cili ende vijon procesi i rivlerësimit. Në situatën hipotetike të dhënies masë disiplinore me vendim të KPK-së, Këshilli do të duhet të deklarojë mbarimin e caktimit të përkohshëm të këtij gjyqtari duke e transferuar atë në një gjykatë apeli me juridiksion të përgjithshëm deri në përfundimin, me vendim të formës së prerë, të procesit të rivlerësimit kalimtar. Në rast konfirmimi në detyrë të gjyqtarit në fjalë, Këshilli mund të operojë menjëherë për shpalljen e lirë edhe të këtij pozicioni të rezervuar hipotetikusht për transferimin e këtij gjyqtari.

Referuar numrit të pozicioneve të lira në gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm, si dhe numrit të gjyqtarëve në detyrë në këto gjykata, duke u orientuar drejt qëllimit për të mundësuar një funksionalitet sa më të mirë të këtyre gjykatave, Komisioni konsideron më oportune që pozicioni i rezervuar hipotetikusht për transferimin e këtij gjyqtari të jetë një nga pozicionet e lira në Gjykatën e Apelit Tiranë. Për rrjedhojë, sipas projektvendimeve, Komisioni i propozon Këshillit që për në Gjykatën e Apelit Tiranë, të shpallë hapjen e procedurave për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve për 7 pozicione të lira.

Sipas projektvendimeve të propozuara, Komisioni ka vlerësuar se pozicionet për të cilat duhet të hapet procedura e ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit me juridiksion të

përgjithshëm të përcaktohen në dy fusha të së drejtës, konkretisht në fushën e të drejtës civile dhe të së drejtës penale. Gjithashtu është vlerësuar që në gjykatat që kanë më shumë se një pozicion të lirë, të jenë në të dy fushat e të drejtës, ato civile dhe penale.

Konkretisht, sipas projektvendimeve, Komisioni propozon hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile dhe të së drejtës penale:

-për Gjykatën e Apelit Tiranë (në raportin 4 pozicione të lira në fushën e së drejtës civile dhe 3 pozicione të lira në fushën e së drejtës penale ose 5 pozicione të lira në fushën e së drejtës civile dhe 2 pozicione të lira në fushën e së drejtës penale dhe i Këshillit të vlerësojë dhe të vendosë për këtë çështje);

-për Gjykatën e Apelit Durrës dhe për Gjykatën e Apelit Korçë (ku numri i pozicioneve të lira në secilën prej tyre është 2 pozicione nga të dy fushat e së drejtës);

-për Gjykatën e Apelit Shkodër, për Gjykatën e Apelit Vlorë dhe për Gjykatën e Apelit Gjirokastrë (ku numri i pozicioneve të lira në secilën prej tyre është 1 pozicion në fushën e së drejtës civile, duke konsideruar kështu se volumi më i madh i çështjeve të regjistruara historikisht në këto gjykata është në lëndë civile).

Konsiderimi më tepër për pozicionet në fushën e së drejtës civile, për të cilët propozohen të hapen procedurat për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm, Komisioni ka mbajtur parasysh edhe se në gjykatat e shkallës së parë, numri më i madh i gjyqtarëve është në seksion civil, rrethanë kjo që teorikisht krijon premisa dhe rrit pritshmëritë për kandidim në këto pozicione të lira.

Ndaj sa më sipër, KZHK propozon 14 projektvendime për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në 6 gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm, gjithsej për 14 pozicione të lira, në fushën e së drejtës civile dhe në fushën e së drejtës penale si dhe 2 projektvendime për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, gjithsej për 2 pozicione të lira.

Sa i përket përmbajtjes, projektvendimet përbëhen nga 4 krerë.

Kreu I - Hapja e procedurës dhe shpallja e kërkesës për thirrje për kandidatura.

Kreu II - Afati i kandidimit:

Për në Gjykatën e Apelit Tiranë: i) në rastin e dy pozicioneve të para për secilën fushë të së drejtës civile/penale, afati i kandidimit është 15 ditë; ii) në rastin e dy

pozicioneve të dyta për secilën fushë të së drejtës civile/penale, afati i kandidimit është 20 ditë; iii) në rastin e dy pozicioneve të treta për secilën fushë të së drejtës civile/penale, në variantin e raportit 4/3 të pozicioneve, afati i kandidimit është 25 ditë, kurse në variantin e raportit 5/2 të pozicioneve, për pozicionin e tretë në fushën e të drejtës civile, afati i kandidimit është 25 ditë; iv) për pozicionin e katërt në fushën e të drejtës civile afati është 30 ditë; v) për pozicionin e pestë në fushën e të drejtës civile, në variantin e raportit 5/2 të pozicioneve, afati i kandidimit është 35 ditë;

Për në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Korçë për pozicionet në secilën fushë të së drejtës civile/penale, afati i kandidimit është 15 ditë;

Për në Gjykatën e Apelit Shkodër, Vlorë dhe Gjirokastrë për pozicionin në fushën e së drejtës civile, afati i kandidimit është 15 ditë;

Për në Gjykatën Administrative të Apelit: i) në rastin e pozicionit të parë, afati i kandidimit është 15 ditë; ii) në rastin e pozicionit të dytë, afati i kandidimit është 20 ditë.

Kreu III - Informacioni dhe dokumentacioni që i bashkëlidhet kandidimit, ku projektvendimet japin informacion për kriteret e ngritjes në detyrë në pozicionet e lira të shpallura, si dhe për dokumentacionin e kandidimit dhe vendin e dorëzimit të tij.

Kreu IV - Procedura e kandidimit, përcaktohen procedurat që Këshilli do të ndjekë në kuadër të procedurave respektive për ngritjen në detyrë. Pas përfundimit të afatit të kandidimit, kandidatët i nënshtrohen procesit të verifikimit të plotësimit të kriterëve ligjorë të kandidimit sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019. Më tej parashikohet fillimi menjëherë i procesit të vlerësimit etik dhe profesional. Ndërsa për përfundimin me sukses të procedurës së ngritjes në detyrë është e domosdoshme edhe bërja e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, për fillimin dhe bërjen në kohë të këtij vlerësimi, është parashikuar që Këshilli të disponojë paraprakisht në lidhje me verifikimin e kriterëve ligjorë të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, pra me përjashtim të kriterit të pasurisë dhe figurës, për të cilin procesi kërkon më tepër kohë, ndërkohë që ai vijon paralelisht me procesin e vlerësimit etik dhe profesional të kandidimit që plotëson kriteret e tjera të kandidimit.

Për ata kandidatë që janë verifikuar dhe kanë kaluar me sukses edhe kriterin e pasurisë dhe figurës, pas përfundimit të procesit të vlerësimit etik dhe profesional, zbatohet procedura e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë sipas Vendimit të Këshillit të

Lartë Gjyqësor nr. 70, datë 07.02.2020. Në këtë vendim rregullohet dhe procedura që ndiqet më pas, pra renditja e kandidatëve, përzgjedhja e kandidatit të renditur më lart dhe vendimi i Këshillit për ngritjen në detyrë.

Bashkëlidhur projektvendimeve janë edhe dy formularët tip, që kandidatët duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë në momentin e aplikimit, konkretisht: i) formulari - Vetëdeklarim për masë disiplinore dhe ii) formulari - Vetëdeklarim për situatën e papajtueshmërisë ambientale.

Gjithashtu zoti Toska shprehet, në përfundim të relatimit, sa i përket rihapjes së procedurave në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sa i përket afateve të kandidimit, Këshilli mund të konsiderojë për të gjitha pozicionet e lira, që afati i kandidimit të jetë 2 javë. Ndërkohë, kërkon gjithashtu që Këshilli të marrë në konsideratë edhe hapjen e pozicioneve të lira në Gjykatën e Apelit Tiranë 4 pozicione të lira në fushën e së drejtës civile dhe 3 pozicione të lira në fushën e së drejtës penale ose 5 pozicione të lira në fushën e së drejtës civile dhe 2 pozicione të lira në fushën e së drejtës penale.

Diskutime/Komente/Pyetje/Propozime mbi çështjen

Zoti Medi Bici drejton një pyetje sa i përket arsyetimit të Komisionit lidhur me ngritjen në detyrë pa bërë lëvizjet paralele.

Komisioni ka vlerësuar që të ndiqen procedurat pasi Këshilli është në proces për të emëruar të diplomuarit rishtazi (të diplomuarit në qershor 2020), ndërkohë, ligji ka konsideruar që mund të mos ndiqen procedurat e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë për kategorinë e kandidatëve që do të diplomohen gjatë periudhës kalimtare. Në këtë situatë, mund të ndiqen procedurat për ngritjen në detyrë, - *shton zoti Toska*. Procedurat për lëvizje paralele nuk mund të ndiqen sot, sa kohë nuk janë përfunduar aktet nënligjore si dhe duhet të ndiqen edhe proceset e vlerësimit të gjyqtarëve. Nga ana tjetër, -shton zoti Toska, plotësimi i vendeve të lira në gjykatat e apeleve, është vlerësuar nga Komisioni si shumë emergjent dhe është parashtruar në relacion arsyetimi se pse është emergjent. Gjithashtu në arsyetim është vlerësuar edhe informacioni i marrë nga grupi i punës që po

merret me hartën e re gjyqësore, ku mendohet që numri i gjykatave të apeleve do të reduktohet.

Merr fjalën më tej **zonja Brunilda Kadi**, e cila është kundër pjesërisht akteve të propozuara, përveç 2 vendeve në Apelin Administrativ, ndërsa për pozicionet e tjera nuk mund të tolerohet në këtë shkallë shkelja e ligjit. Në dispozitat tranzitore lejohej që të mënjanohej lëvizjet paralele dhe kjo është bërë për magistratët e rinj, por nuk është cenuar asnjë magistrat. Ndërsa ajo që shikohet si problematike nga zonja Kadi në këto projektvendime është që magistratët që janë në gjykatat e apeleve do të cenohen dyfish, pasi u hiqet e drejta për të qenë në kushte të privileguara në kandidim kur hapet një vend në nivel apeli sepse ata thirren të parët për të kandiduar.

Situata faktike dhe arsyetimi i Komisionit është i kuptueshëm, por zonja Kadi mendon që kjo nuk është justifikim i mjaftueshëm për të shkelur ligjin në këtë pjesë.

Nga ana tjetër, harta e re gjyqësore është një ngjarje e pasigurt dhe varianti më i mirë që mund të ndodhë është të paktën pas 1 viti, pasi vetë grupi i punës nuk e ka kaluar akoma, ndërkohë që qeveria ka edhe 18 muaj në dispozicion që ta certifikojë dhe të vendosë. Pra nuk është një ngjarje e sigurt, pasi mund të ndodhë që të qëndrojnë 6 apele apo më pak.

Ndaj, për të gjitha këto arsye, zonja Kadi është kundër projektvendimeve për ngritjen në detyrë pa zbatuar procedurën ligjore të lëvizjes paralele, me përjashtim të 2 vendeve në Gjykatën e Apelit Administrativ, gjykatë në të cilën Këshilli nuk ka mundësi për të bërë lëvizje paralele nisur nga rrethanat që janë pasqyruar në relacion, për shkak të kriterit të posaçëm që kërkohet për këto 2 vende.

Fjalën më pas e merr **zonja Brikena Ukperaj** e cila mbështet faktin që ligji e shpreh në mënyrë të qartë që Këshilli nuk mund të bëjë ngritje në detyrë, pa bërë lëvizje paralele. Sistemimi i magistratëve në shkallët e para mund të bëhet nëpërmjet lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Nga ana tjetër është e vërtetë që dispozitat tranzitore parashikon që për sistemimin e tyre, nuk është e nevojshme që të pritet ngritja në detyrë dhe lëvizja paralele, por në situatën aktuale, patjetër që duhen hapur vendet sepse nuk ka vende të lira. Vendet e lira janë vetëm në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë

dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë Durrës. Pra strategjia që të bëhen ngritje në detyrë në apel pa bërë lëvizje paralele sepse duhen për magjistratët në shkallë të parë, mund të zëvendësohet duke zbatuar ligjin dhe hapur procedurat për lëvizje paralele për gjyqtarët në gjykatën e shkallës së parë.

Lidhur me situatën në gjykatat e apeleve, zonja Ukperaj është dakord me propozimin për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë për Gjykatën e Apelit Shkodër, Gjykatën e Apelit Korçë, Gjykatën e Apelit Gjirokastrë dhe Gjykatën e Apelit Vlorë, sepse në këto gjykata mund të ketë gjyqtarë që duan të bëjnë lëvizje paralele nga njëra gjykatë tej tjetra. Nga ana tjetër, pozicionet janë 1 dhe mund të plotësohen vetëm nëpërmjet ngritjes në detyrë. Gjithashtu edhe për Gjykatën Administrative të Apelit, të vijohet hapja e procedurës, pasi nuk lejohet lëvizja paralele. Ndërsa për Gjykatën e Apelit Durrës dhe për Gjykatën e Apelit Tiranë, që kanë edhe më shumë pozicione, zonja Ukperaj vlerëson që plotësimi i tyre të bëhet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, për t'iu krijuar mundësi gjyqtarëve të gjykatave të apeleve në rrethe për të ardhur në Gjykatën e Apelit Tiranë ose në Gjykatën e Apelit Durrës. Vendet që mund të krijohen, mund të plotësohen nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Zoti Toska merr fjalën në vijim të diskutimeve të zonjës Kadi dhe Ukperaj, i cili kërkon të dijë si mund të plotësohen vendet në gjykatat e apeleve ku në përgjithësi numri aktualisht i gjyqtarëve ka rënë në 50% dhe vazhdon të bie. Lëvizjet paralele nuk e rrisin këtë numër.

Zonja Ukperaj, në përgjigje, shprehet se nga delegimet, rezulton se kërkesat e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Durrës janë nga 1 dhe se delegime të shumta kanë gjykatat e apeleve në rrethe (Shkodra, Gjirokastra, Vlora, Korça). Sipas zonjës Ukperaj nuk mund të paragjykohet procesi duke thënë që po ikin të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë.

Në vijim **zoti Toska** thekson lidhur me saktësinë e të dhënave se në Gjykatën e Apelit Durrës nuk ka 1 apo 2 kërkesa, por ka shumë kërkesa që duhet të caktohen gjyqtarë në çështje të veçanta. Ajo që zoti Toska ngre për shqetësim është se ku do të

gjinden gjyqtarët e gjykatave të apeleve që do duhet të ushtrojnë detyrën në këto gjykata, pasi lëvizja paralele nuk e rrit numrin, por thjesht sposton nga një gjykatë në një tjetër. Gjithashtu zoti Toska shprehet se nëse do të vijohet me lëvizjet paralele pas përfundimit të akteve nënligjore dhe më pas të vijohet me ngritjen në detyrë, kjo do të hante një kohë shumë të gjatë dhe ndërkohë gjykatat do të jenë jashtë funksionit. Komisioni ka konsideruar të mbajë në funksionalitet gjykatat e apeleve.

Edhe **zonja Kadi** jep mendimin e saj në përgjigje të sa më lart, duke u shprehur se nxjerrja jashtë funksionit të gjykatave të apelit nuk duhet të jetë justifikim për të shkelur ligjin e për të cenuar të drejtat e magistratëve. Edhe nga ana praktike ka zgjidhje, - shprehet zonja Kadi, pasi vendet që sillen si propozim për t'u hapur në Gjykatën e Apelit Tiranë janë 8 edhe sikur të vijnë të gjithë të bëjnë kërkesë nga apelet e rretheve, ato nuk dalin jashtë funksionit pasi mund të zgjidhet me skemë delegimi siç është zgjidhur me apelin e Korçës. Gjithashtu zonja Kadi drejton edhe pyetjen Komisionit lidhur me rregulloren për procedurat e lëvizjes paralele.

Zoti Toska e rimerr sërish fjalën duke u shprehur se nuk po anatemon mendimin që mund të ketë një anëtar i Këshillit, por ajo që konsideron se duhet të jetë në vëmendjen e Këshillit është përgjegjësia që Këshilli ka për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor dhe parësore është mbajtja në funksion të gjykatave.

Lidhur me pyetjen e bërë nga zonja Kadi për rregulloren e procedurave të lëvizjes paralele, zoti Toska shprehet se Komisioni është në përmbyllje të draftit. Ndërsa lidhur me pyetjen e zonjës Ukperaj mbi nëse mund të ndodhë që vendet që krijohen në gjykatat e apeleve në rrethe të plotësohen me ngritjen në detyrë më pas, zoti Toska shprehet se për të bërë lëvizje paralele, kjo kërkon një kohë të caktuar, ndërkohë edhe ngritja në detyrë kërkon një kohë tjetër të caktuar dhe për disa muaj mund të mbyllen këto procedura.

Pas diskutimeve/pyetjeve për këtë çështje dhe pas diskutimeve mbi mënyrën e votimit të akteve, hidhet fillimisht në votim në parim propozimi i ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për hapjen e procedurave për ngritjen në detyrë për të gjitha

gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është kundër.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord pjesërisht, pasi është kundër hapjes në gjykata të caktuara.

Medi Bici është kundër.

Naureda Llagami është dakord.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me shumicë votash u dakordësua për hapjen e procedurave për ngritjen në detyrë në të gjitha gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm.

Hidhet në votim miratimi i projektvendimit të parë të propozuar nga KZHK “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”. Rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është kundër.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është kundër, për shkak të arsytimit të bërë më sipër.

Medi Bici është kundër.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi miratimin e projekt-aktit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”, sipas propozimit të bërë nga KZHK-ja.

Hidhet në votim miratimi i projektvendimit të dytë të propozuar nga KZHK “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”. Rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është kundër.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është kundër.

Medi Bici është kundër.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi miratimin e projekt-aktit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”, sipas propozimit të bërë nga KZHK-ja.

Hidhet në votim miratimi i projektvendimit të tretë të propozuar nga KZHK “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”. Rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është kundër.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.
Erjon Muharremaj është dakord.
Brikena Ukperaj është dakord.
Medi Bici është kundër.
Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi miratimin e projekt-aktit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”, sipas propozimit të bërë nga KZHK-ja.

Hidhet në votim miratimi i projektvendimit të katërt të propozuar nga KZHK “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”. Rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.
Brunilda Kadi është kundër.
Ilir Toska është dakord.
Alban Toro është dakord.
Fatmira Luli është dakord.
Marçela Shehu është dakord.
Erjon Muharremaj është dakord.
Brikena Ukperaj është dakord.
Medi Bici është kundër.
Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi miratimin e projekt-aktit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”, sipas propozimit të bërë nga KZHK-ja.

Hidhet në votim miratimi i projektvendimit të pestë të propozuar nga KZHK “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”. Rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është kundër.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është kundër.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi miratimin e projekt-aktit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”, sipas propozimit të bërë nga KZHK-ja.

Hidhet në votim miratimi i projektvendimit të gjashtë të propozuar nga KZHK “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”. Rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është kundër.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është kundër.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi miratimin e projekt-aktit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”, sipas propozimit të bërë nga KZHK-ja.

Sa i përket Gjykatës së Apelit Tiranë, Komisioni ka propozuar 2 variante sa i përket numrit të pozicioneve në secilën fushë të së drejtës: Varianti i parë 4 pozicione të lira në fushën e së drejtës civile dhe 3 pozicione të lira në fushën e së drejtës penale; ose varianti i dytë 5 pozicione të lira në fushën e së drejtës civile dhe 2 pozicione të lira në fushën e së drejtës penale.

Hidhet në votim fillimisht në parim varianti i parë 4 pozicione të lira në fushën e së drejtës civile dhe 3 pozicione të lira në fushën e së drejtës penale në Gjykatën e Apelit Tiranë. Rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është kundër.

Brunilda Kadi është kundër.

Ilir Toska është kundër.

Alban Toro është kundër.

Fatmira Luli është kundër.

Marçela Shehu është kundër.

Erjon Muharremaj është kundër.

Brikena Ukperaj është kundër.

Medi Bici është kundër.

Naureda Llagami është kundër.

Me shumicë votash, Këshilli bie dakord për variantin e dytë të propozuar nga KZHK-ja, për 5 pozicione të lira në fushën e së drejtës civile dhe 2 pozicione të lira në fushën e së drejtës penale, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Hidhen në votim miratimi i 5 projektvendimeve të propozuara nga KZHK “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”. Rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është kundër.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është kundër.

Medi Bici është kundër.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi miratimin e 5 projekt-akteve “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”, sipas propozimit të bërë nga KZHK-ja.

Hidhen në votim miratimi i 2 projektvendimeve të propozuara nga KZHK “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”. Rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është kundër.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është kundër.

Medi Bici është kundër.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi miratimin e 2 projekt-akteve “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”, sipas propozimit të bërë nga KZHK-ja.

Hidhet në votim miratimi i projektvendimit të katërmbëdhjetë të propozuar nga KZHK “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”. Rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është kundër.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është kundër.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi miratimin e projekt-aktit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”, sipas propozimit të bërë nga KZHK-ja.

Hidhen në votim miratimi i 2 projektvendimeve të propozuara nga KZHK “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Apelit” (për dy pozicione të lira). Rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Ilir Toska është dakord.
Alban Toro është dakord.
Fatmira Luli është dakord.
Marçela Shehu është dakord.
Erjon Muharremaj është dakord.
Brikena Ukperaj është dakord.
Medi Bici është dakord.
Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi miratimin e 2 projekt-akteve “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Apelit” (për dy pozicione të lira), sipas propozimit të bërë nga KZHK-ja.

Hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit edhe propozimi tjetër i ardhur nga relatori gjatë leximit të relacionit shpjegues, që fati për të gjitha pozicionet e shpallura të jetë dyjavor. Rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.
Brunilda Kadi është dakord për pozicionet e lira për të cilat ka votuar ‘pro’.
Ilir Toska është dakord.
Alban Toro është dakord.
Fatmira Luli është dakord.
Marçela Shehu është dakord.
Erjon Muharremaj është dakord.
Brikena Ukperaj është dakord për pozicionet e lira për të cilat ka votuar ‘pro’..
Medi Bici është dakord për pozicionet e lira në Gjykatën Administrative të Apelit.
Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, anëtarët e Këshillit bien dakord që afati i kandidimit për të gjitha këto pozicione të lira të shpallura, të jetë 2-javor.

Zonja Ukperaj në përfundim merr fjalën për të theksuar se në rast se do të konsiderohet ky një rend i ri i shpalljes së procedurave për ngritje në detyrë, në njoftimin që do të bëhet në faqen zyrtare të internetit, të specifikohet që të drejtën për të aplikuar në këto procedura, e kanë të gjithë gjyqtarët, pavarësisht nëse kanë aplikuar në procedura të tjera për ngritje në detyrë.

Zoti Toska thekson se do të kihet parasysh kur të bëhet njoftimi publik në faqen e internetit, së bashku me vënien e kufizimit të tre pozicioneve të lira.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 28.05.2020)

Pika 11 shtesë e rendit të ditës me objekt: Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 16:55.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Illir Toska* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
9. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Dritan Hallunaj**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 5. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.**

RENDI I DITËS:

11 shtesë. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Merr fjalën zoti Toska i cili lexon relacionin shpjegues “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Gjirokastër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Gjirokastër** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Apelit Vlorë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Në opsionin e pranimit të propozimit si me lart, duke mbajtur parasysh informacionin e marrë nga Gjykata e Apelit Gjirokastër në lidhje me gjyqtarët e gjykatave të tjera të apelit që kanë planifikuar gjykime në këtë gjykatë për javën në vijim, për hapat e shortit të konsiderohet se për 1 çështje, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, ai të përzgjidhet me short ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Vlorë, të ngarkuar më

herët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, konkretisht Petrit Aliaj, Margarita Buhali, Skënder Damini, Hysen Saliko dhe Sokol Ngresi.

Anëtarët e Këshillit janë dakord me këto propozime të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet gjyqtarja Margarita Buhali, e cila caktohet për të gjykuar çështjen e veçantë në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë.

* * *

(Pika 11 shtesë e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor